



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 22/2023 (JR)
Datë 25.05.2023

Vendim nr. 66 (JR)
Datë 22.09.2025

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi Gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Mimoza Tasi	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 22.09.2025, ditën e hënë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me sekretare gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Arben Kostandini, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 636, datë 15.03.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 42 dhe neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Neni F i Aneksit të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; Nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66 pika 1, germa “b” të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës të Shqipërisë”; Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Trupi Gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatoe të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Arben Kostandini (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*.
2. Në përputhje me nenet 31, pika 1¹, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar brenda afatit ligjor në organet përkatëse ndihmëse, deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit (në vijim “deklarata vetting”), në datën 25.01.2017, brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi², deklaratën për kontrollin e figurës pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) administroi raportet e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”).

3.1. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit të pasurisë, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë³ së subjektit të rivlerësimit Arben Kostandini, duke konkluduar se: (i) *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin*; (ii) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë*; (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë*; (iii) *nuk ka kryer deklarim të rremë*; (iv) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.

¹ Subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon atë pranë ILDKPKI-së.

² Referuar parashikimit kushtetues të nenit 84/3, datës së miratimit të ligjit nga Parlamenti dhe datës të botimit të ligjit në Fletoren Zyrtare, si dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, për pezullimin dhe rrëzimin e kërkesës për shfuqizim, ligji hyri në fuqi në datën 08.10.2016. Në datën 25.10.2016, ligji u pezullua nga Gjykata Kushtetuese. Për këtë arsye, afati i zbatimit të ligjit eci për 17 ditë deri më 19.01.2017. Në datën 18.01.2017, Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën për shfuqizimin e ligjit. Ky vendim u botua në Fletoren Zyrtare në datën 19.01.2017. Si rezultat, afati 30-ditor në dispozicion të subjekteve të rivlerësimit për dorëzimin ka përfunduar në datën 31.01.2017.

³ Me shkresën nr. {***} prot., datë 12.10.2018, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë, të deklaratës së pasurisë së subjektit Arben Kostandini”.

3.2. DSIK-ja vuri në dispozicion të Komisionit raportin për kontrollin e figurës⁴, për subjektin e rivlerësimit, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Arben Kostandini.

3.3. KLGj-ja ka përcjellë në Komision raportin⁵ për vlerësimin e aftësive profesionale, për subjektin e rivlerësimit Arben Kostandini.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit, të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, si dhe kreu një hetim të plotë administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit, arriti në konkluzionet si vijojnë:

4.1. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, *subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*

4.2. Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, *subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.*

4.3. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, *rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë”, duke arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.*

4.4. Në vlerësimin tërësor të çështjes, *subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, ka cenuar besimin e publikut tek drejtësia.*

5. Komisioni, bazuar në konkluzionet e mësipërme, me vendimin nr. 636, datë 15.03.2023, vendosi: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Arben Kostandini, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë [...].*

III. Shkaqet e ankimit

6. Subjekti i rivlerësimit Arben Kostandini, në datën 18.05.2023, ka ushtruar ankim kundër vendimit nr. 636, datë 15.03.2023, të Komisionit, duke kërkuar nga Kolegji: (i) prishjen e vendimit të Komisionit dhe përsëritjen e hetimit administrativ ose në alternativë ndryshimin e këtij vendimi dhe konfirmimin e tij në detyrë; (ii) shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në prani të palëve.
7. Shkaqet e ankimit, lidhur me procesin e rregullt ligjor dhe aspektet procedurale të procesit të rivlerësimit, parashtrohen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

7.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit është në kundërshtim me: (i) praktikën e konsoliduar të Kolegjit; (ii) me përcaktimet e nenit 6 të Konventës Evropiane për

⁴ Raporti nr. {***} prot., datë 31.10.2017, gjithashtu, Komisionit i është komunikuar nga DSIK-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 30.11.2022, se raporti i sipërcituar është deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {***}, datë 18.11.2022, të KDZh-së.

⁵ Raporti i përgatitur nga Grupi i Punës me nr. {***} prot., datë 18.12.2020.

të Drejtat e Njeriut, në aplikimin e standarteve të dyfishta dhe me shkeljen e parimit të një gjykate të zgjedhur me ligj; (iii) parimet e arsyetimit të vendimit në përputhje me ligjin, të aksesit, të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, të pavarësisë dhe paanësisë, të barazisë para ligjit, të ligjshmërisë dhe të mungesës së fuqisë prapavepruese të ligjit.

7.2. Komisioni ka aplikuar standartin e dyfishtë, duke u larguar nga praktika e deritanishme në raport me subjekte të tjerë, konkretisht për: (i) ligjshmërinë e të ardhurave nga personat e lidhur, për të cilat punëdhënësi nuk ka paguar tatimet; (ii) shpenzimet jetike të familjarëve të gjyqtarëve; (iii) mosllogaritjen e kursimeve *cash* dhe mosdublimit të diferencës që vjen nga pasaktësitë në vite të kurimeve *cash*.

7.3. Komisioni ka kryer shkelje të procesit të rregullt ligjor, pasi duke mosaplikuar parimin e dyfishit të pasurisë ka cenuar parimin e sigurisë juridike, si shkak i vetëm për të cilën mund të merret masa disiplinore e shkarkimit nga detyra. Subjekti pretendon se konkluzioni i Komisionit se ai ka kryer fshehje të pasurisë është tërësisht i pabazuar, pasi ai ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij.

8. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si në vijim.

8.1. *Lidhur me pasurinë apartament me sip. 75,2 m², në rrugën “{***}”, Tiranë dhe shtesa anësore me sip. 40 m² e legalizuar në vitin 2021.*

8.1/a. Subjekti i rivlerësimit pretendon se mosdeklarimi i shtesës anësore dhe shpenzimeve të kryera për të nuk përbën shkelje ligjore, pasi shtesa anësore prej 41 m² është ndërtuar në vitet 1996-1997 dhe është përdorur si pjesë e apartamentit ekzistues. Në kushtet kur shtesa është deklaruar për legalizim në vitin 2006 dhe legalizimi është kryer në vitin 2021, bazuar në ligjin nr. 9049/2003, ky ndërtim nuk përbënte detyrim për deklarim në *formën e shpenzimit të deklarueshëm*.

8.1/b. Lidhur me koston e ndërtimit të shtesës, subjekti pretendon se ajo është më e ulët nga sa ka përlllogaritur Komisioni, pasi referuar çmimeve zyrtare të vitit 1997 dhe metodologjisë së Entit Kombëtar të Banesave (në vijim “EKB”), kostoja reale e shtesës është afërsisht 477.969 lekë dhe çmimit duhet t’i zbritet masa prej 30% të zërave të kostove që nuk përfshihen në ndërtimet informale.

8.1/c. Subjekti pretendon se përlllogaritja e të ardhurave dhe shpenzimeve jetike në analizën financiare të Komisionit për periudhën 1988 – 1997 është e pasaktë, pasi ka përlllogaritur të ardhurat e tij në vlerë më të ulët se pensionet e prindërve, ndonëse ai ka punuar që prej vitit 1979 dhe së bashku me prindërit kanë pasur burime të mjaftueshme për të mbuluar investimin.

8.2. *Lidhur me pasurinë apartament me sip. 126 m², të ndodhur në rrugën “{***}”, pallati “{***}” ShPK, Tiranë*

8.2/a. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit për trajtim preferencial në blerjen e apartamentit, duke sqaruar se: (i) marrëveshja për blerjen e apartamentit është arritur që në vitin 2005 në mënyrë verbale, mbi bazën e një marrëdhënieje miqësore shumëvjeçare me drejtuesit e shoqërisë “{***}” ShPK; (ii) çmimi prej 9.500.000 lekësh, i përcaktuar në kontratën e vitit 2016, është në përputhje me çmimet e vitit 2005, kur është shfaqur vullneti për

blerjen; (iii) Kodi Civil (neni 80) lejon shfaqjen e vullnetit edhe në mënyrë verbale për veprime juridike; si dhe (iv) shoqëria “{***}” ShPK nuk ka qenë palë në ndonjë proces gjyqësor të zhvilluar prej tij, ndaj nuk ka konflikt interesi.

8.2/b. Lidhur me mosdeklarimin e përdorimit të apartamentit për periudhën 2010 – 2016, subjekti pretendon se: (i) nuk ka pasur detyrimin ligjor për të deklaruar pasurinë që nuk ishte ende në pronësi të tij, detyrimi ligjor për të deklaruar pasuritë në përdorim është vendosur për herë të parë në mënyrë të qartë me ligjin nr. 84/2016 dhe në Aneksin e Kushtetutës; (ii) ligji i mëparshëm nr. 9049/2003 kërkonte deklarimin e pasurisë vetëm nëse ishte në pronësi.

8.2/c. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit për fshehje të pasurisë, duke pretenduar se: (i) përdorimi i apartamentit nuk ka qenë rezultat i funksionit të tij si gjyqtar, por i marrëveshjes së hershme për blerjen dhe marrëdhënien e ngushtë miqësore me drejtuesit e shoqërisë “{***}” ShPK; (ii) formalizimi i kontratës është bërë në momentin kur ishin siguruar mjetet monetare për blerje dhe jo për të shmangur detyrime deklarimi; (iii) nuk ka pasur qëllim për fshehje, pasi vetë drejtuesja e shoqërisë “{***}” ShPK ka dëshmuar për ekzistencën e marrëveshjes verbale.

8.2/ç. Subjekti i rivlerësimit kundërshton si të pabazuar dhe kontradiktor konkluzionin e Komisionit se ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën prej (-) 3.438.705 lekësh, për të blerë apartamentin me sip. 126 m² nga shoqëria “{***}” ShPK, pasi vlera reale e këtij bilanci negativ, sipas faqes 22 të vendimit të Komisionit, është (-) 2.738.705 lekë, për rrjedhojë përlllogaritja përfundimtare në faqen 24 të vendimit konsiderohet e gabuar dhe në kundërshtim me vetë analizën financiare të kryer prej Komisionit. Konkretisht: (i) subjekti pretendon se Komisioni nuk ka marrë parasysh të ardhurat e ligjshme të bashkëshortes; (ii) shpenzimet e jetesës për vitin 2007 duhet të përlllogariten në të njëjtën masë me vitin 2008; si dhe (iii) analiza financiare e Komisionit ka probleme që lidhen me përlllogaritjet e gjendjeve *cash* në vite.

8.3. Lidhur me konstatimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme në lidhje me krijimin e kursimeve *cash*, të cilat janë deklaruar si burim për blerjen e apartamentit në vitin 2016, ai pretendon se analiza financiare e Komisionit është e pasaktë dhe e gabuar, duke listuar elementet si më poshtë:

i) Komisioni duhet të kishte vlerësuar mundësinë e kursimit të tij dhe të bashkëshortes në funksion të të ardhurave të përfituara gjatë viteve, pa u mbështetur në deklaratimet periodike vjetore të pasurisë;

ii) kursimet e tij nga paga, të cilat janë përfshirë në DIPP-në e vitit 2008, nuk janë përdorur dhe janë mbajtur për t’u përdorur kur të ishte e nevojshme dhe se gabimet e bëra gjatë plotësimit të deklaratave të interesave periodike vjetore nuk kanë pasur qëllim fshehjen e të ardhurave;

iii) përlllogaritjet e likuiditetit *cash* të vitit 2014 janë të gabuara, pasi shuma prej 2.600.302 lekësh, e tërhequr nga banka dhe mbajtur në banesë, nuk është marrë parasysh si një shtesë e ligjshme. Kjo ka sjellë një përlllogaritje të pasaktë të gjendjes *cash* të vitit 2014, e cila ka ndikuar në vlerësimin e tij të pasurisë;

iv) analiza financiare e Komisionit ka gabime metodologjike, si përlllogaritja e diferencave negative në mënyrë të paqëndrueshme dhe në këtë analizë duhet të përfshihen vetëm shumat e ligjshme të të ardhurave që janë përdorur për krijimin e pasurive dhe se, pas korrigjimeve të bëra, analiza financiare për vitin 2016 do të rezultojë pozitive me shumën prej 341.986 lekësh.

v) mosdeklarimin e gjendjeve të llogarive bankare në deklaratat e interesave periodike të viteve, subjekti e argumenton me faktin se të gjitha shumat janë të ardhura nga paga e tij dhe e

bashkëshortes, të cilat janë deklaruar në DIPP-të përkatëse të viteve, duke qenë se këto ishin llogari rrjedhëse, me burim të ardhurat nga pagat, ato kanë qenë të kontrollueshme në çdo kohë. vi) gjendja *cash* në fund të vitit 2016 është 300.000 lekë dhe nga analiza financiare e tij rezulton se ai ka mundur të krijojë pasuri të ligjshme gjatë këtij viti, duke refuzuar konkluzionin e Komisionit se ka mungesë burimesh të ligjshme për këtë periudhë.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

9. Lidhur me juridiksionin e Kolegjit, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, që kanë për objekt rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

10. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 e ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

11. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “trupi gjykues i Kolegjit”), fillimisht mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi vendimin nr. 636, datë 15.03.2023, të Komisionit. Në këndvështrim të pretendimeve të parashtruara në ankim nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me procesin e rregullt ligjor dhe konstatimin në mënyrë të plotë të gjendjes faktike, trupi gjykues nuk evidentoi shkelje procedurale apo konstatim të gabuar të situatës faktike, të cilat, në kuptim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, do të sillnin nevojën e debatit gjyqësor në seancë gjyqësore publike për korrigjimin e tyre. Për rrjedhojë, trupi gjykues vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor dhe aspektet procedurale të procesit të rivlerësimit

12. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka vepruar në kundërshtim me praktikën e konsoliduar të Kolegjit⁶, duke u larguar nga praktika e deritanishme në raport me subjekte të

⁶ Subjekti referon në vendimet nr. 35, datë 23.12.2020 dhe nr. 15, datë 18.06.2021, të Kolegjit.

tjerë konkretisht për: (i) ligjshmërinë e të ardhurave nga personat e lidhur, për të cilat punëdhënësi nuk ka paguar tatimet; (ii) shpenzimet jetike të familjarëve të gjyqtarëve; (iii) mosllogaritjen e kursimeve *cash*⁷ dhe mosdublimit të diferencës që vjen nga pasaktësitë në vite të kursimeve *cash*⁸, si rrjedhojë, duke mbajtur standard të dyfishtë në raste të ngjashme, Komisioni ka minuar besimin e publikut në procesin e *vetting*-ut.

12.1. Trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë se këto pretendime të subjektit të rivlerësimit do të analizohen në mënyrë të detajuar më poshtë në këtë vendim së bashku me shkaqet e ankimit me natyrë materiale, që lidhen me analizimin e problematikave të pasurive të subjektit të rivlerësimit. Nenet 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016 parashikojnë qëllimin dhe objektin e ligjit⁹. Zbatimi në praktikë i dispozitave të mësipërme nënkupton që vlerësimi i ndryshëm i situatave të njëjta, për subjekte të ndryshme, duhet të jetë i mirëarsyetuar dhe i mirëbazuar, për të shmangur perceptimin e paragjyqimeve për një subjekt rivlerësimi. Në rastin konkret, nga analiza e akteve në fashikull, rezulton që për secilën çështje Komisioni ka analizuar faktet dhe provat që janë paraqitur gjatë procesit, që janë administruar në gjykim, si dhe ka argumentuar qëndrimin e mbajtur në përfundim të vlerësimit.

12.2. Trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin e konsoliduar tashmë në jurisprudencën e Kolegjit¹⁰ se standardet e ndryshme të mbajtura nga Komisioni për çështje të ngjashme nuk mund të adresohen si shkaqe ankimi, për sa kohë që u përkasin trupave gjykues të ndryshëm, të cilët ushtrojnë veprimtarinë si të pavarur nga njëri-tjetri. Çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, sipas shkaqeve konkrete të ankimit, të cilat lidhen me vlerësimin e kriterëve të rivlerësimit, bazuar në specifikat e gjendjes faktike të provuara nga gjykimi dhe zbatimit të duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni. Gjithashtu, trupi gjykues thekson se për sa kohë shqyrtimi i ankimit të subjektit do të kryhet në Kolegji, duke u referuar në aktet e çështjes që i përkasin asaj dhe të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, është e panevojshme dhe e paarsyeshme të kryhen kontrolle apo referime mbi elementë të caktuar të vlerësimit të pasurisë apo kriterëve të tjera që Komisioni ka bërë në një vendim tjetër të tij. Trupi gjykues sjell në vëmendje parimin se vlerësimi i subjekteve të rivlerësimit që kanë kryer të njëjtat shkelje duhet të mbështetet në specifikat dhe rrethanat që kanë sjellë shkeljen e kryer, në raport me kuadrin ligjor të identifikuar për zbatim, duke shmangur vlerësime të ndryshme për situata të njëjta, në konsideratë edhe të qëndrimeve të mbajtur nga Gjykata Kushtetuese¹¹ dhe GjEDNj-ja.

⁷ Subjekti referon në vendimet nr.1, datë 27.01.2022 dhe nr. 2, datë 14.07.2022, të Kolegjit.

⁸ Subjekti referon në vendimet nr. 26/2022 dhe nr. 27/2022, të Kolegjit.

⁹ Neni 1 i ligjit nr. 84/2016, në objektin e tij, përcakton: “Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të posaçme për rivlerësimin kalimtar të të gjithë subjekteve të rivlerësimit për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi, sipas parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës”. Neni 2 përcakton objektin e këtij ligji: “1. Parimet e organizimit të procesit të rivlerësimit për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët. 2. Metodologjinë, procedurat dhe standardet e rivlerësimit. 3. Organizimin dhe funksionimin e institucioneve të rivlerësimit. 4. Rolin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, të organeve të tjera shtetërore dhe të publikut në procesin e rivlerësimit”.

¹⁰ Vendimet nr. 7/2019 (JR) dhe nr. 34/2021 (JR), të Kolegjit.

¹¹ Në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 71, datë 02.12.1998, ndër të tjera, citohet se: “[...] Barazia në ligj dhe para ligjit nuk duhet kuptuar se për çështje gjyqësore të pretenduara identike, të ketë zgjidhje të njëjtoja nga gjykatat. Mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykatë, sepse çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, e harmonizuar me rrethanat, faktorë, motive apo prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë absolutisht të njëjtoja. [...] Barazia në ligj dhe para ligjit nuk ka të bëjë me

12.3. Në kuadër të analizimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit nuk është shkarkuar nga detyra për shkak të deklarimeve të kryera në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, por pasi Komisioni ka konstatuar se ai nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas analizës së kryer nën dritën e nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pikat 3 e 5 të ligjit nr. 84/2016. Problematikat e konstatuara në vlerësimin e pasurisë së subjektit kanë pasur për bazë analizën e kryer për pasuritë e deklaruar prej tij në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit [vetting] dhe konstatimin se ai nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave. Nga ana tjetër, deklaratat periodike vjetore, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, sipas nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji. Për rrjedhojë, kontrolli i pasurive të deklaruar në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin është objekt i kontrollit të pasurisë gjatë rivlerësimit. Ky kontroll mund të përfshijë edhe krahasimin me deklarimet ndër vite, për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të subjektit në lidhje me pasurinë e deklaruar. Për pasojë, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit për cenimin e parimit të sigurisë juridike, pasi masa disiplinore e marrë nga Komisioni ka qenë konkluzion i hetimit administrativ të kryer, analizës së deklaratës së pasurisë dhe shpjegimeve të subjektit, nën dritën e kuadrit kushtetues e ligjor të hartuar për rivlerësimin.

13. Lidhur me pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit se *nga hetimi administrativ ka rezultuar që ai nuk ka më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme*, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Komisioni argumenton se subjekti i rivlerësimit, ndër vite, ka pasur mungesë të të ardhurave të ligjshme për krijimin e pasurisë dhe për mbulimin e kostove të jetesës. Në asnjë pjesë të vendimit të Komisionit nuk mbahet qëndrim se pasuria e subjektit të rivlerësimit është më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme. Trupi gjykues i Kolegjit në vijim do të analizojë në mënyrë të detajuar shkaqet e ankimit që lidhen me pasurinë, duke i dhënë në këtë mënyrë përgjigje edhe pretendimit të subjektit të rivlerësimit, lidhur me saktësimin e vlerës së mungesës së burimeve të ligjshme financiare. Pavarësisht analizës në vijim, Kolegji vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se pasuria e tij nuk është sa dyfishi i pasurisë së ligjshme dhe, si e tillë, nuk duhet të përbëjë shkak për shkarkim, është i pabazuar dhe, si rrjedhojë, pa ndikim në zgjidhjen e çështjes, për sa kohë që kjo situatë ligjore nuk ka përbërë shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit. Komisioni ka konkluduar për mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë, duke e kualifikuar situatën, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe jo sipas nenit 61, pika 1, që parashikon sanksionin për rastet në të cilat vërtetohet dyfishi i pasurisë së ligjshme.
14. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *është njohur me shkakun mbi të cilin është bazuar masa disiplinore e shkarkimit të tij nga detyra vetëm në vendimin e Komisionit*, trupi gjykues vlerëson se qëllimi i hetimit administrativ nuk është të njoftojë apo t'i bëjë të ditur subjektit të rivlerësimit se provat e grumbulluara mund të çojnë drejt prezumimit të vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sikurse pretendon subjekti në çështjen konkrete, por se provat e grumbulluara kishin mjaftueshëm nivelin e provueshmërisë për të mbështetur konstatimet e Komisionit në përfundim të fazës së hetimit administrativ. Trupi gjykues, nga verifikimi i aktit të rezultateve të hetimit administrativ të përcjellë subjektit, konstaton se përmban gjithë gjetjet e Komisionit, për të tria kriteret e vlerësimit, duke dhënë për çdo gjetje

mënyrën se si është zgjidhur çështja në themel, por me garancitë ligjore, me të drejtat që shteti ka vënë në dispozicion të qytetarëve të tij për zgjidhjen e problemeve të tyre. [...]”.

konstatimet e faktit dhe aktet mbi të cilat janë bazuar. Për çdo gjetje, subjektit të rivlerësimit i është kaluar nga Komisioni barra e provës dhe ai kishte detyrimin ligjor për të provuar të kundërtën. Subjekti, duke u njohur me rezultatet e hetimit paraprak, ka pasur mundësinë të perceptojë se cili është konkluzioni i rezultateve paraprake të hetimit, për të cilat duhet të paraqiste shpjegime bindëse dhe prova, në rast të mosdakordësisë dhe kundërshtimit të tyre. Dispozitat kushtetuese dhe ligji nr. 84/2016 kanë të përcaktuara qartë se si kryhet procesi i rivlerësimit, kriteret për të cilat bëhet ky proces, aktet mbi të cilat bazohet, si dhe mënyrën e deklarimit dhe detyrimet e subjekteve të rivlerësimit në kuadër të këtij procesi. Kuadri ligjor për rivlerësimin ka të përcaktuara qartë rastet kur mospërmbushja e detyrimeve nga subjektet apo pasaktësitë, deklarimet e pamjaftueshme apo jo me vërtetësi të interesave pasurore, përbëjnë shkaqe për dhënien e masave disiplinore, të cilat, gjithashtu, janë të përcaktuara qartë për çdo shkelje. Për këto arsye, subjekti i rivlerësimit nuk mund të priste që Komisioni ta orientonte apo përcaktonte se cilat ishin shkeljet e mundshme që ai mund të kishte kryer, pasi ai vetë duhet të ishte i vetëdijshëm për rezultatet apo pasojat që do të vinin në kuadër të deklarimeve prej tij në këtë proces dhe verifikimit të vërtetësisë së tyre nga Komisioni dhe në rast mungese të shpjegimeve apo paraqitjes së provave, ato mund të passillnin vendosjen e një mase disiplinore¹².

15. Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit se *Komisioni ka vepruar në shkelje të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, pasi nuk ka marrë në konsideratë dhe nuk ka vlerësuar shpjegimet dhe provat e paraqitura prej tij*, trupi gjykues, pas analizimit të vendimit të Komisionit, konstaton se në tërësinë e tij janë pasqyruar aktet e sjella si prova mbi të cilat subjekti ka mbështetur argumentet e tij. Komisioni ia ka nënshtruar vlerësimit të tij provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit, duke mbajtur qëndrim mbi vlerën provuese të akteve të sjella, atyre të cilat janë çmuar prej tij dhe ndikimin apo efektin që ato kanë mbi çështjet e ngritura, në zbatim të parimit të parashikuar nga neni 81 i Kodit të Procedurave Administrative¹³. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se rezultati përfundimtar i Komisionit nuk është diktuar nga moskonsiderimi i provave, por nga interpretimi dhe vlerësimi i tyre, sipas bindjes së brendshme dhe në raport me kërkesat ligjore.
16. Trupi gjykues mori në shqyrtim edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit se i është cenuar rëndë parimi i arsyetimit të vendimit në përputhje me ligjin, duke dëshmuar pamjaftueshmëri profesionale nga ana e trupit gjykues të Komisionit. Në funksion të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues, duke mbajtur në konsideratë jurisprudencën¹⁴ e konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese, e cila thekson domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si një garanci për procesin e rregullt ligjor dhe se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë, sipas së cilës vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Nga analizimi i vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, trupi gjykues konstatoi se ai është arsyetuar në përputhje me standardet e kërkuara nga Gjykata Kushtetuese, në të kanë gjetur pasqyrim

¹² Vendimet e Kolegjit nr. 3/2023, paragrafi 12.14, që i përket subjektit të rivlerësimit T. H. dhe nr. 38/2023, paragrafi 16.1, që i përket subjektit të rivlerësimit S. S..

¹³ Organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ.

¹⁴ Vendimet nr. 3, datë 26.01.2015, nr. 63, datë 23.09.2015, nr. 24, datë 25.04.2016 dhe nr. 73, datë 16.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese.

pretendimet e subjektit të rivlerësimit, është kryer analiza e provave dhe është shpjeguar bazueshmëria ligjore për shkeljet e konstatuara. Kolegji vëren se mënyra se si trupi gjykues i Komisionit i ka zbardhur në vendim qëndrimet/shpjegimet e subjektit duket se nuk është një riprodhim literal i deklarimeve të tij. Pavarësisht këtij elementi, trupi gjykues vlerëson se jo domosdoshmërisht Komisioni ka për detyrë të kryejë pasqyrime literale të asaj që deklarojnë subjektet, madje ndonjëherë kjo është e pamundur dhe e vështirë, por ajo që është e rëndësishme dhe duhet garantuar lidhet me moscenimin e vërtetësisë së deklarimeve dhe mosnxjerrjes së tyre jashtë kontekstit, në të cilat ato janë bërë, duke krijuar një imazh të deformuar të këtyre të dhënave. Konkretisht, në rastin në analizë, Komisioni, siç edhe vepron përgjithësisht, ka vlerësuar të japë një përmbledhje të informacionit që japin këto shpjegime, si dhe të informacionit që ka rezultuar nga kontrolli që ka kryer vetë Komisioni, për rrjedhojë e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vendimi është i paarsyetuar.

17. Lidhur me shkaqet e tjera të ankimit, në drejtim të cenimit të parimeve të procesit të rregullt, që kanë të bëjnë me pretendimet e subjektit të rivlerësimit për shkeljen e parimit të një gjykate të zgjedhur, referuar nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe, për rrjedhojë, shkeljes së parimit të pavarësisë dhe paanësisë, parimit të barazisë para ligjit, si dhe parimit të ligjshmërisë, trupi gjykues konstaton se, përveç faktit që subjekti nuk ka referuar të dhëna konkrete për disa nga shkeljet e pretenduara, këto pretendime në ankimin e tij nuk lidhen në mënyrë specifike me çështje apo situata konkrete të rastit objekt shqyrtimi, por janë pretendime që lidhen në tërësi me zhvillimin e procesit të rivlerësimit nga Komisioni, të cilat, përveçse kanë gjetur trajtim të gjerë në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, gjithashtu, janë bërë objekt gjykimi e vlerësi edhe i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), e cila në vendimin e dhënë për çështjen *A. Xh. kundër Shqipërisë*, të datës 09.02.2021, ka mbajtur qëndrimin e saj për të gjitha çështjet e ngritura në ankim e të lartcituara, duke i dhënë një zgjidhje përfundimtare analizës ligjore në nivel kushtetute e konvente të këtyre shkaqeve, qëndrime të cilat u japin përgjigje shteruese edhe pretendimeve të ngritura prej subjektit të rivlerësimit si më lart. Kështu, në vijim të këtij konstatimi, Kolegji sjell në vëmendje se pretendimi i subjektit se kjo çështje nuk është gjykuar nga një gjykatë e krijuar me ligj ka gjetur përgjigje në vendimin e GjEDNj-së *A. Xh. kundër Shqipërisë* të datës 09.02.2021, në të cilin është arsyetuar se: [...] *Gjykata arrin në përfundimin se, duke pasur parasysh faktin se si KPK ashtu dhe KPA ishin krijuar dhe formuar në një mënyrë legjitime duke përmbushur kërkesat e një "gjykate të krijuar me ligj", kërkesja i ishte adresuar "Gjykatës", sipas kuptimit të kushtit të parë të testit Vilho Eskelinen [...].* Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

18. Trupi gjykues, pasi kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit të subjektit në Komision, si dhe analizoi dokumentacionin e fashikujve të administruar gjatë hetimit të tij, konstatoi se: (i) nuk rezulton asnjë qëndrim paragjykues i mbajtur nga Komisioni dhe as ndonjë pretendim i ngritur nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në këtë drejtim; (ii) procesi i rivlerësimit është kryer sipas parashikimeve të akteve ligjore e rregullatorë; (iii) këto pretendime janë ngritur nga subjekti i rivlerësimit vetëm pas njohjes me vendimin përfundimtar të Komisionit, për rrjedhojë i bën këto pretendime të tij të pabazuara. Procedura e ndjekur nga ana e Komisionit, në trajtimin e kërkesave të subjektit për marrjen e provave, rezulton të jetë kryer në përputhje me parashikimet e nenit 49, pika 9 e ligjit nr.

84/2016 dhe, për rrjedhojë, nuk u konstatuan shkelje të natyrës procedurale, të cilat mund të përbënin cenim të së drejtës së subjektit për proces të rregullt ligjor.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

19. *Për pasurinë apartament me sip. 75,2 m², të ndodhur në rrugën “{***}”, pallati {***}, Tiranë dhe shtesë anësore me sip. 41 m², legalizuar në vitin 2021*

19.1. Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit: (i) ka ndërtuar shtesën anësore prej 41 m² të apartamentit me sip. 75,2 m², në rrugën “{***}”, në vitet 1996 -1997, të cilën nuk e ka deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2003; (ii) nuk ka deklaruar vlerën e investimit të saj në deklaratën *vetting*; dhe (iii) ka rezultuar me pamundësi të ardhurash të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në vlerën (-) 184.083 lekë.

19.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se mosdeklarimi i shtesës anësore prej 41 m² në deklaratat e interesave periodike nuk përbën shkelje ligjore, pasi ajo është ndërtuar në vitet 1996-1997, është deklaruar për legalizim në vitin 2006 dhe procesi i legalizimit ka përfunduar në vitin 2021. Ky *ndërtim* nuk përbënte detyrim për deklarim në *formën e shpenzimit të deklarueshëm*, bazuar në ligjin nr. 9049/2003. Sipas subjektit, detyrimi për deklarim është vendosur me ligjin nr. 85/2012 “Për ndryshimin e ligjit nr. 9049/2003”, për shpenzimet mbi vlerën 500.000 lekë gjatë vitit të deklarimit, por kur shtesa është ndërtuar para vitit 1999, mosdeklarimi i shpenzimeve të kryera për ndërtimin e saj nuk është në shkelje të ligjit nr. 9049/2003. Subjekti referon në vendimin nr. 35, datë 23.12.2020, të Kolegjit.

19.3. Trupi gjykues mori në analizë fillimisht pretendimin e subjektit të rivlerësimit lidhur me arsyet e mosdeklarimit të tij, në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim në vitin 2003, të shtesës anësore prej 41 m², në pasurinë apartament me sip. 75,2 m², të ndodhur në rrugën “{***}”, pallati {***}, Tiranë.

19.3/a. Nga shqyrtimi i dokumentacionit¹⁵ të ndodhur në dosjen e Komisionit, trupi gjykues konstaton se Arben Kostandini ka plotësuar formularin e “*Vetëdeklarimit për legalizim*” nr. {***}, datë 14.11.2006, që konfirmon se subjekti ka vetëdeklaruar pranë Njesisë Bashkiake Nr. {***}, me kërkesën nr. {***}, datë 14.11.2006, për legalizimin e shtesës së apartamentit të banimit në rrugën “{***}”, pallati {***}, shk. {***}, ap. {***}. Ndërsa Agjencia Shtetërore e Kadastrës (AShK Drejtoria Tirana Veri) ka konfirmuar¹⁶ se me vendimin nr. {***}, datë 13.04.2021, subjekti ka legalizuar shtesën anësore me sip. 41 m², në katin II të pallatit ekzistues, ku ka në pronësi apartamentin me sip. 75,2 m², si dhe ka paguar¹⁷ taksën përkatëse në vlerën 6.590 lekë.

19.3/b. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartament me sip. 75,2 m² në rrugën “{***}”, Tiranë dhe shtesa anësore 40 m² në proces legalizimi. Pjesa: 100%. Si burim krijimi ka deklaruar: Kontratë privatizimi datë 09.11.1993. Trashëgimia e babait me vendimin nr. {***}, datë 10.11.2011, të Gjykatës Tiranë. Trashëgimia e nënës sipas*

¹⁵ Me shkresën nr. {***} prot., datë 20.09.2018, të ALUIZNI-t Drejtoria Tirana 2, drejtuar ILDKPKI-së (dosja *vetting*).

¹⁶ Shkresë nr. {***} prot., datë 08.11.2022, e ASHK-së Drejtoria Tirana Veri, drejtuar Komisionit.

¹⁷ Sipas mandatpagesës, datë 09.04.2021, të Tirana Bank.

aktit noterial nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.03.2015. Kontrata e privatizimit dhe shtesa anësore është paguar nga prindërit e mi. Kontratë dhurimi nga vëllai R. K. nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.09.2015. Bashkëlidhur deklaratës vetting, subjekti ka depozituar dokumentacionin ligjor¹⁸.

19.4. Trupi gjykues, nga kontrolli i deklaratave të interesave periodike pasurore (në vijim DIPP), të dorëzuara prej subjektit pranë ILDKPKI-së, nuk konstaton që ai të ketë deklaruar këtë shtesë apo vlerën e investuar për ndërtimin e saj në deklaratën e parë të vitit 2003, por edhe më pas. Gjithashtu, nuk rezulton të jetë deklaruar kjo shtesë as në vitin 2006, vit në të cilin subjekti i rivlerësimit ka aplikuar pranë ALUIZNI-t për legalizim të sipërfaqes së ndërtuar. Referuar dokumentacionit në dosje, kjo shtesë, periudha e ndërtimit dhe vlera e investimit të saj, nuk është deklaruar as në pyetësonin standard, por vetëm në përgjigje të pyetësorit nr. 2, të Komisionit. Në deklaratën e pasurisë vetting, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar shtesën së bashku me apartamentin me sip. 75,2 m², në rrugën “{***}”, Tiranë (subjekti e ka deklaruar këtë apartament që nga viti 2003 e në vijim), por nuk ka deklaruar vlerën e investimit të shtesës anësore, duke u mjaftuar me togfjalëshin *shtesa anësore është paguar nga prindërit e mi*.

19.5. Trupi gjykues e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nuk ka pasur detyrim për deklarim të shtesës anësore me sip. 41 m², pasi kjo shtesë duhej të deklarohej prej tij në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim të vitit 2003, si deklarim për herë të parë, kur ka hyrë në fuqi ligji nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i cili në nenin 4/a i referohet pasurive të paluajtshme dhe të drejtave reale mbi ato. Dispozitat e këtij ligji nuk bëjnë dallim nëse pasuria është e regjistruar apo e legalizuar, por për pasuri reale dhe shpenzime të rëndësishme, ndërsa neni 6 i tij përcakton detyrimin e subjekteve që në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji të deklarojnë të gjitha pasuritë e akumuluar, detyrimet financiare dhe burimin e tyre. Gjithashtu, në formularin e deklarimit, pjesë e këtij ligji, përcaktohet si objekt deklarimi çdo lloj pasurie e regjistruar ose jo në regjistrat publikë. Për këto arsye, shtesa me sip. 41 m² e objektit ekzistues duhej të deklarohej në vitin 2003, si një pasuri e paluajtshme e re, e cila ishte ndërtuar me kursime familjare dhe është përdorur nga subjekti dhe familja e tij, përfshirë edhe prindërit.

19.6. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nuk ka deklaruar vlerën e investimit të shtesës anësore në deklaratën vetting, pasi nuk ka pasur dokumente/fatura për shpenzimet e

¹⁸ (1) Certifikatë pronësie datë 25.09.2015, ku subjekti figuron pronar i vetëm i pasurisë nr. {***}, vol. {***}, fq. {***}, z. k. nr. {***}, apartament me sip. 75,50 m²; (2) kontratë shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.01.1994, e lidhur midis shitësit Ndërmarrjes Komunale Banesa Nr. {***} dhe blerësve F. K., N. K. dhe Arben Kostandini, për shitjen e këtij apartamenti 2+1 në katin 3, kundrejt çmimit 1.572 lekë; (3) kontratë privatizimi datë 09.11.1993 e lidhur midis palëve si më lart për të njëjtin apartament; (4) vendimi nr. {***}, datë 10.11.2011, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, që përcakton si trashëgimtarë ligjorë të z. F. K., bashkëshorten N. dhe dy djemtë e tij Arben e R. Kostandini; (5) certifikatë pronësie, datë 14.12.2011, ku N., Arben e R. Kostandini janë bashkëpronarë të apartamentit si më lart; (6) vendim nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.11.2011, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë që përcakton si trashëgimtarë ligjorë të zj. N. K. dy djemtë e saj Arben e R. Kostandini; (7) certifikatë pronësie, datë 08.04.2015, ku figurojnë bashkëpronarë subjekti dhe vëllai i tij R. K., për apartamentin si më lart; (8) kontratë dhurimi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.09.2015, ku R. K. i dhuron subjektit pjesën e vet të këtij apartamenti; (9) formular vetëdeklarimi nga subjekti për legalizim të shtesës së këtij apartamenti; (10) vërtetim nr. {***} prot., datë 23.01.2017, nga ALUIZNI (Drejtoria “Tirana 2”), që konfirmon se subjekti ka vetëdeklaruar pranë Njësisë Bashkiake Nr. {***}, me kërkesën nr. {***} prot., datë 14.11.2006, për legalizimin e shtesës së apartamentit të banimit në rrugën “{***}”, pallati {***}, shk. {***}, ap. {***}.

kryera, sepse janë marrë prindërit e tij për ndërtimin e saj, trupi gjykues çmon të theksojë se ky detyrim përcaktohet në formularin nr. 4 *“Deklarata e pasurisë për procesin e rivlerësimit”*, pjesë e ligjit nr. 84/2016. Në këtë deklaratë përcaktohen si objekt deklarimi *vlera e krijimit të pasurisë dhe çmimi* i blerjes dhe në mungesë të dokumenteve për këto të deklarohet shuma e shpenzimeve të kryera. Për rrjedhojë, bazuar në detyrimet kushtetuese ligjore dhe përcaktimeve të detajuara të tyre nëpërmjet udhëzimit nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, të Inspektorit të ILDKPKI-së, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

19.7. Gjithashtu, trupi gjykues e vlerëson të pasaktë krahasimin që subjekti i rivlerësimit kryen në raport me vendimmarrje të tjera dhe konkretisht vendimin nr. 35, datë 23.12.2020, të Kolegjit (pika 83), pasi situata dhe rrethanat nuk janë të njëjta. Në rastin të cilit i referohet subjekti i rivlerësimit ka të bëjë me një pasuri që nuk është pasuri e paluajtshme, në kuptim të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim”* dhe as të dispozitave të Kodit Civil (objekti shtesë ishte pa themele dhe i mbështetur në avllinë e fqinjit, për të cilin nuk plotësohet kriteri i trupëzimit të tij me tokën, në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme). Për më tepër që referuar dhe jurisprudencës së Kolegjit¹⁹ çdo rast trajtohet dhe analizohet bazuar në dokumentacionin dhe provat që përmban ajo çështje.

19.8. Subjekti i rivlerësimit pretendon se kosto e ndërtimit të shtesës është më e ulët nga sa ka përlllogaritur Komisioni, pasi referuar çmimeve zyrtare të vitit 1997 dhe metodologjisë së EKB-së, kostoja reale e shtesës është afërsisht 477.969 lekë dhe çmimit duhet t’i zbritet masa prej 30% të zërave të kostove që nuk përfshihen në ndërtimet informale. Sipas subjektit, Komisioni ka përfshirë në mënyrë të pasaktë elementë shtesë në koston e ndërtimit (si faqet e pallatit, ballkoni, mungesa e ambienteve të shtrenjta). Subjekti pretendon se kjo shtesë është bërë me 6 punëtorë ndërtimi dhe me procedurat e ndërtimit janë marrë prindërit e tij, prandaj nuk disponon asnjë dokument apo faturë për pagesat e kryera dhe vlerën totale të investimit. Sipas aktekspertimit të bërë nga eksperti, vlera e investimit është rreth 381.852 lekë.

19.8/a. Në pyetësin nr. 2, subjekti ka dhënë shpjegime në lidhje me vlerën e investuar për ndërtimin e shtesës, duke deklaruar se ndërtimi shtesë është bërë në vitet 1996 -1997, si shtesë anësore e pallatit 5-katësh {***}, shk. {***}, ku ai banonte dhe është në funksion të apartamentit ekzistues, pasi nuk ka hyrje dhe shkallë më vete. Vlera e investimit është rreth 400.000 lekë krijuar nga kursimet familjare ndër vite. Bashkëlidhur, subjekti ka depozituar aktet²⁰ e përmendura në përgjigje të pyetësin.

19.8/b. Trupi gjykues konstaton se për sa i përket llogaritjes së koston të ndërtimit të shtesës anësore, Komisioni, në përfundim, ka përlllogaritur vlerën e investimit në shumën 619.269 lekë, duke zbritur nga çmimi referues i EKB-së elementet e koston në masën 8.83%, përkatësisht fitimit të planifikuar dhe fondit rezervë, duke u bazuar në jurisprudencën tashmë të konsoliduar të Kolegjit, për përlllogaritjen e kostove të ndërtimit. Trupi gjykues, pasi konstatoi se subjekti i

¹⁹ Vendimet nr. 57/2024, paragrafi 14.11, nr. 35/2022 paragrafi 34 dhe nr. 33/2022, paragrafi 25, të Kolegjit.

²⁰ Planimetrinë e shtesës anësore të katit 2, si dhe raportin e vlerësimit teknik të kryer nga eksperte private I. S., në lidhje me vlerën e ndërtimit që ka rezultuar në vlerën 381.852 lekë. Në lidhje me mobilimin e shtesës, subjekti deklaron se nuk ka bërë mobilim të veçantë, por ka përdorur mobilet ekzistuese, si dhe ka depozituar deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.07.2020, ku L. S. deklaron se është djali i tezes së subjektit dhe për apartamentin e ri i ka bërë disa mobilje të reja, si dhe i ka përshtatur disa mobilje që i ka pasur në apartamentin e mëparshëm. Këto punime ia ka bërë falas për shkak të marrëdhënies së veçantë si kushërinj e njëkohësisht si bashkëmoshatarë që nga fëmijëria.

rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për vlerën e shpenzuar të ndërtimit të shtesës, e vlerëson të drejtë referimin e Komisionit në përlllogaritjen e kostos së ndërtimit, bazuar në çmimet e përcaktuara për metër katror të miratuara nga EKB-ja²¹, aq më tepër që çmimet e referuara prej saj kanë vlera minimaliste. Ndërsa raportin e vlerësimit teknik të kryer për këtë shtesë nga eksperte private I. S., e cila ka përcaktuar si vlerë për ndërtimin e shtesës shumën prej 381.852 lekësh, hartuar me porosi të subjektit dhe në funksion të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues e konsideron me një vlerë të kufizuar provuese.

19.8/c. Trupi gjykues e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit për zbritjen 30% të zërave të kostos së ndërtimit dhe vlerëson se vlera e përlllogaritur për ndërtimin e shtesës anësore me sipërfaqe 41m², në shumën prej 619.269 lekësh, është e drejtë. Konkretisht, mënyra e përlllogaritjes nga Komisioni e kostos së ndërtimit, duke zbritur nga çmimi referues i EKB-së elementet e kostos në masën 8.83%, përkatësisht fitimit të planifikuar dhe fondit rezervë, bazuar në manualët e preventivimit të punimeve të ndërtimit dhe formatit të analizës teknike të punimeve të ndërtimit, miratuar me udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i cili është në përputhje edhe me jurisprudencën e Kolegjit, për përlllogaritjen e kostove të ndërtimit²².

19.9. Subjekti i rivlerësimit pretendon se përlllogaritja e të ardhurave dhe shpenzimeve jetike në analizën financiare të Komisionit për periudhën 1988 – 1997 është e pasaktë, pasi ka përlllogaritur të ardhurat e tij në vlerë më të ulët se pensionet e prindërve, ndonëse ai ka punuar që prej vitit 1979 dhe së bashku me prindërit kanë pasur burime të mjaftueshme për të mbuluar investimin. Sipas subjektit, Komisioni ka llogaritur shpenzimet jetike si 66% të të ardhurave, gjë që bie ndesh me jurisprudencën e Kolegji, që rekomandon përdorimin e normës 30% për funksionarët publikë me të ardhura më të larta.

19.9/a. Në funksion të analizimit të këtij shkaku ankimi²³, referuar burimeve të hapura²⁴ apo dhe raporteve studimore, por edhe bazuar në vendimmarrje të mëparshme të Kolegjit²⁵, në lidhje me përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës në masën 30% të të ardhurave të periudhës përkatëse, trupit gjykues i rezulton se pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve kanë qenë mesatarisht rreth 30% më të larta krahasuar me pagat e funksionarëve të tjerë të administratës publike. Nisur nga këto të dhëna dhe duke marrë në konsideratë nivelin e përgjithshëm të kostove të jetesës, Kolegji ka arsyetuar se në rastet kur të ardhurat burojnë nga funksioni i gjyqtarit apo prokurorit, shpenzimet jetike mund të përlllogariten në masën 30% të të ardhurave. Kjo përqindje përafron në mënyrë proporcionale me nivelin e shpenzimeve jetike prej 66% të të ardhurave për kategoritë me paga mesatare në sistemin publik. Për rrjedhojë, në analizën e kryer në Kolegji, në ndryshim nga Komisioni, shpenzimet jetike për periudhën 1995-1997 u përlllogaritën në masën 30% të të ardhurave.

²¹ Për vitin 1997 (sipas vendimit nr. 13, datë 05.01.1998), në vlerën 16.657 lekë/m².

²² Vendimi nr. 7/2022 regjistër (JR), datë 29.03.2022, i Kolegjit.

²³ Konstatohet se subjekti nuk ka kontestuar llogaritjen e shpenzimeve të jetesës pas dërgimit nga ana e Komisionit të rezultateve të hetimit, por e ka ngritur këtë pretendim për herë të parë në ankimin e depozituar në Kolegji.

²⁴ Bazuar në studime të publikuara nga Banka e Shqipërisë në raportin e saj të vitit 1995, si dhe në të dhëna të tjera të disponueshme në burime të hapura.

²⁵ Sipas vendimit nr. 15/2021, të Kolegjit, ky standard është aplikuar në raste kur subjekti ka ushtruar funksionin e gjyqtarit përpara vitit 2003.

19.10. Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit për mospërlllogaritje të saktë të të ardhurave, trupi gjykues, pasi kontrolloi dhe analizoi dokumentacionin financiar të depozituar nga subjekti, konstaton se në analizën financiare të Komisionit nuk janë reflektuar të ardhurat e bashkëshortes së tij nga puna për periudhën para vitit 1997 dhe në vendim nuk është dhënë ndonjë shpjegim për këtë. Për pasojë, në përlllogaritjet e kryera në Kolegj u përfshinë të ardhurat e përfituara nga puna e bashkëshortes së subjektit në vlerën prej 71.666 lekësh.

Nga sa më lart, në analizën financiare të rishikuar në Kolegj për subjektin e rivlerësimit dhe anëtarët e familjes së tij për periudhën 1988 – 1997, pasi u përfshinë një pjesë e pretendimeve të subjektit, ai rezulton me një balancë pozitive prej 149.158 lekësh, për këtë periudhë.

19.11. Në përfundim, për pasurinë apartament me sip. 75,2 m², të ndodhur në rrugën “{***}”, pallati {***}, Tiranë dhe shtesë anësore me sip. 41 m², trupi gjykues, në ndryshim nga Komisioni, pasi i konsideroi të drejta një pjesë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, arriti në konkluzionin se subjekti dhe familjarët e tij kanë pasur mundësi për të përballuar shpenzimet e jetesës dhe për të financuar me të ardhura të ligjshme krijimin e pasurisë shtesë anësore me sip. 41 m².

20. Për pasurinë apartament me sip. 126 m², të ndodhur në rrugën “{*}”, pallati “{***}” ShPK, në Tiranë**

20.1. Komisioni, lidhur me këtë pasuri, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit: (i) *Ka përfutur trajtim preferencial nga shoqëria “{***}” ShPK, për shkak të blerjes me çmim disa herë më të ulët të apartamentit krahasuar me çmimin referencë dhe çmimin e kontratave të ngjashme, si dhe në lidhje me lënien e këtij apartamenti në përdorim për 6 vjet rresht pakundërshpërblim, ndërkohë që nuk ka bërë deklarime në lidhje me këtë trajtim preferencial.* (ii) *Nuk ka deklaruar përdorimin e apartamentit pakundërshpërblim në DIPP-të e viteve 2010 – 2016 dhe as adresën e këtij apartamenti si adresë banimi, pavarësisht përdorimit të tij.* (iii) *Ka pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën (-) 3.438.705 lekë për të blerë apartamentin me sip. 126 m² nga shoqëria “{***}” ShPK.* (iv) *Qëndron dyshimi i arsyeshëm se subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur ndër vite këtë marrëdhënie me këtë pasuri (apartament), për shkak të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare dhe për ta formalizuar atë vetëm në vitin 2016, për efekt të procesit të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, veprime këto që në tërësinë e tyre të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut tek drejtësia.*

20.2. Subjekti i rivlerësimit e konsideron të pabazuar ligjërisht dhe të paargumentuar konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit është trajtuar me çmim preferencial nga shoqëria “{***}” ShPK, për blerjen e apartamentit, duke pretenduar se: (i) marrëveshja për blerjen e apartamentit është arritur që në vitin 2005 në mënyrë verbale, mbi bazën e një marrëdhënieje miqësore shumëvjeçare me drejtuesit e shoqërisë “{***}” ShPK; (ii) çmimi prej 9.500.000 lekësh i përcaktuar në kontratën e vitit 2016 është në përputhje me çmimet e vitit 2005 kur është shfaqur vullneti për blerjen; (iii) Kodi Civil (neni 80) lejon shfaqjen e vullnetit edhe në mënyrë verbale për veprime juridike; (iv) shoqëria “{***}” ShPK nuk ka qenë palë në ndonjë proces gjyqësor të zhvilluar prej tij, ndaj nuk ka konflikt interesi; (v) sipas vendimit nr. 16/2020 të Kolegjit, nuk jemi përpara një trajtimi preferencial në kuptim të ligjit nr. 9367/2005, pasi në momentin e dakordësisë për blerjen nuk ka ekzistuar ndikimi i pozitës zyrtare të subjektit.

20.3. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim deklarinimet e subjektit ndër vite, si dhe gjatë hetimit administrativ në Komision, dokumentacionin e administruar, të dhënat për çmimet e apartamenteve të ndodhura në të njëjtën njësi ku ndodhet apartamenti pronë e subjektit të rivlerësimit, i analizoi ato nën këndvështrimin e konkluzioneve të Komisionit rreth kësaj çështjeje dhe pretendimeve të subjektit të parashtruara në ankim, konstaton dhe vlerëson si vijon.

20.3/a. Në pyetësin standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në harkun kohor 01.12.2010 - 23.9.2016 ka banuar në apartamentin me adresë rruga “{***}”, nd. {***}, pallati “{***}” ShPK, shk. {***}, ap. {***}, Tiranë, që e ka pasur në përdorim nga shoqëria “{***}” ShPK, pa pagesë. FShU-ju ka konfirmuar se subjekti ka lidhur për këtë apartament kontratën e furnizimit nr. {***}, që në datën 13.04.2007 dhe, sipas konsumit, rezulton se apartamenti ka filluar të banohet në shtator 2010.

20.3/b. Në lidhje me këtë fakt, në pyetësin nr. 2, subjekti ka shpjeguar se me V. dhe E. K. (drejtues të shoqërisë “{***}” ShPK), njihen qysh fëmijë dhe kanë miqësi shoqërore e familjare përfshirë edhe z. M. L. (ortak i kësaj shoqërie dhe vëllai i znj. E. K.). Për këtë arsye, subjekti me bashkëshorten e tij kanë porositur verbalisht apartamentin 2+1, me sip. 126 m², të cilin pas ndërtimit e kanë marrë në përdorim pa pagesë në datën 01.12.2010 derisa të plotësonin paratë dhe të lidhnin kontratën e shitjes në datën 23.09.2016. Subjekti pretendon se nuk e ka deklaruar këtë pasuri, sepse nuk kishte dokument të shkruar. Përdorimin e apartamentit nuk e ka çmuar se duhej ta deklaronte meqenëse marrëdhënia ishte verbale dhe do ta deklaronte pasi të hartohet kontrata e shitjes.

20.3/c. Në pyetësin nr. 3, subjekti ka deklaruar se për shkak të miqësisë që kanë pasur me bashkëshortët K., pronarë të shoqërisë “{***}” ShPK, nuk i është bërë ndonjë trajtim preferencial në lidhje me çmimin e shitjes së apartamentit, për aq sa është rënë dakord, përveçse lënies në përdorim të apartamentit deri në pagimin e çmimit. Bashkëlidhur përgjigjes, subjekti ka depozituar deklaratën e datës 30.07.2020, ku znj. E. K., si përfaqësuese ligjore e shoqërisë “{***}” ShPK, deklaroi se për shkak të marrëdhënieve shoqërore shumë të mira kanë lidhur me Arben e A. Kostandinin marrëveshje verbale për përdorimin e apartamentit pa pagesë, deri në shitjen e tij, meqenëse ata nuk e kishin vlerën e plotë të shitjes në muajin dhjetor 2010, kur e morën në përdorim.

20.3/ç. Komisioni, referuar çmimit referencë të EKB-së për vitin 2016²⁶ për blerje në zonën {***} Tiranë, i cili është 139.500 lekë/m², ka kryer llogaritjen për sip. 126 m² dhe ka konkluduar se çmimi i blerjes së apartamentit duhej të ishte në total 17.577.000 lekë dhe jo 9.500.000 lekë, pra, subjekti ka përfituar apartament me çmim më të ulët se pothuajse gjysma e çmimit referencë. Shpjegimin e subjektit se çmimin e blerjes së apartamentit e ka dakordësuar me miqtë e tij që në vitin 2005, ndërsa në pyetësin nr. 3 ka deklaruar se çmimi është dakordësuar në vitin 2006, Komisioni e ka konsideruar si përpjekje të tij për të deklaruar një vit sa më të hershëm, me qëllim për të justifikuar çmimin e ulët në krahasim me vitet më pas.

²⁶ Udhëzim nr. 3, datë 28.12.2016, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB për vitin 2016”.

20.3/d. Nga verifikimi i procesverbalit të seancës dëgjimore rezulton se pyetjes se përse nuk e lidhi kontratën e shitblerjes me miqtë, të cilët, siç u theksua, i dhanë një çmim preferencial për apartamentin, por kjo kontratë u vonua për 6 vjet, subjekti iu përgjigj se bisedimet janë bërë dhe çmimin e caktuan në kohën kur kishte filluar të ndërtohej pallati dhe kanë qëndruar në kuadrin e miqësisë deri kur ai të siguronte paratë, atëherë do të lidhej edhe kontrata e shitblerjes.

20.4. Lidhur me përcaktimin e kohës se kur mund të jetë dakordësuar nga palët çmimi i apartamentit, trupi gjykues vlerëson se në mungesë të dokumentacionit të kohës periudha më realiste dhe më e arsyeshme për këtë përcaktim do të ishte viti në të cilin subjekti ka filluar të banojë në këtë apartament. Ky qëndrim është në koherencë edhe me deklaratën e datës 30.07.2020 të znj. E. K., administratore e shoqërisë “{***}” ShPK, e cila nuk ka deklaruar ndonjë periudhë se kur është dakordësuar për çmimin e blerjes së apartamentit, por ka konfirmuar se subjekti ka filluar të banojë në këtë apartament në vitin 2010. Në konsideratë të këtij qëndrimi, referuar çmimit referencë të EKB-së për vitin 2010 (vit në të cilin subjekti ka filluar të jetojë në këtë apartament), përsëri rezulton se çmimi i blerjes së apartamentit është më i ulët se ai i përcaktuar në Udhëzimin “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB për vitin 2010”.

20.5. Nga verifikimi i disa kontratave të ngjashme me objekt shitje apartamenti²⁷, të administruara në Komision gjatë hetimit administrativ, që shoqëria “{***}” ShPK ka lidhur me banorë të ndryshëm në të njëjtin pallat ku subjekti ka blerë apartamentin e tij, rezulton se çmimi për metër katror i këtyre apartamenteve varion nga 97.139 lekë/m² – 111.976 lekë/m², ndërsa çmimi i apartamentit që ka blerë subjekti është 75.396 lekë/m², pra, dukshëm më i ulët se ato kontrata.

20.6. Në konkluzion të kësaj analize mbi faktet e rezultuara gjatë hetimit, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit mbi trajtimin preferencial duhet analizuar në raport me rrethanat faktike dhe kualifikimin e trajtimit preferencial, në kuptim të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, neni 23, pika 1 e të cilit parashikonte se: *“1. Është e ndaluar që një zyrtar të kërkojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, nga një individ, person fizik ose juridik privat kur kjo mund të shkaktojë lindjen e një konflikti interesi të çdo lloji”*. Trupi gjykues konstaton se në vitin 2010, kur subjekti ka filluar të banojë në këtë apartament e kur supozohet se është dakordësuar çmimi për përfitimin e apartamentit, si dhe në kohën e lidhjes së kontratës së shitjes në vitin 2016, kur subjekti ka likuiduar çmimin e blerjes së apartamentit, ai nuk gjendej në kushtet e konfliktit të interesit në raport me shoqërinë “{***}” ShPK, për rrjedhojë termat e kushtet e kësaj marrëdhënieje duket se janë vendosur jashtë çdo ndikimi të mundshëm ndaj ndonjë interesi të zyrtarit/subjektit. Ky vlerësim mban në konsideratë faktin se Komisioni hetoi për ndonjë konflikt interesi midis subjektit dhe shoqërisë “{***}” ShPK, por nuk konstatoi²⁸ ndonjë situatë të tillë. Në rastin konkret, në mbështetje të legjislacionit të sipërcituar, rrethanat faktike, në të cilat ndodhej subjekti në raport me pasurinë objekt kontrolli dhe mungesa e ndonjë shtate konkrete që lidhet me gjykimin e ndonjë çështje prej subjektit ku

²⁷ Kontratë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.08.2011; kontratë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.03.2016; kontratë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.07.2011; kontratë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.07.2011; kontratë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.07.2011.

²⁸ Me shkresën nr. {***} prot., datë 02.11.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

shoqëria apo ortakët të ishin palë, zhveshin situatën e marrë në shqyrtim nga kualifikimi i një trajtimi preferencial në kuptim të dispozitave të kohës.

20.7. Në mbështetje të kësaj analize, trupi gjykues vëren se nga faktet e konstatuara gjatë hetimit rezulton se subjekti ka filluar të banojë në apartamentin me adresë rrugën “{***}”, nd. {***}, pallati “{***}” ShPK, në vitin 2010, vit në të cilin pranohet për efekt të përcaktimit të çmimit të referencës se është dakordësuar për çmimin e apartamentit edhe me shoqërinë ndërtuese, ndërsa ligji nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” ka ndryshuar në vitin 2012 me ligjin nr. 86/2012, datë 18.09.2012, në mënyrën që mund të kualifikonte situatën e marrë në analizë si një trajtim preferencial. Konkretisht, neni 23, pika 1 e këtij ligji, ndryshoi si vijon: “[...] është e ndaluar që një zyrtar të kërkojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, nga një individ, person fizik ose juridik privat”. Referuar kësaj dispozite, trajtimi preferencial mund të qëndrojë edhe i pavarur nga konflikti i interesit dhe të krijohet edhe vetëm për shkak të funksionit që ushtron zyrtari, por në kushtet kur marrëdhënia e subjektit me shoqërinë ndërtuese për këtë apartament, edhe pse e paformalizuar, pranohet se ka filluar në vitin 2010, ndërsa ndryshimet ligjore i përkasin një periudhe dy vjet më vonë, në vitin 2012, si i tillë ligji nuk mund të ketë fuqi prapavepruese dhe nuk mund të penalizojë subjektin në këtë drejtim.

Trupi gjykues konstaton se Komisioni nuk ka arritur të provojë nëpërmjet hetimit administrativ se marrëdhënia e krijuar mes subjektit dhe përfaqësuesit të shoqërisë “{***}” ShPK të ketë qenë e lidhur me vendimmarrje të subjektit të rivlerësimit në ndonjë çështje gjyqësore në mënyrë të tillë që kjo vendimmarrje të ketë qenë e ndikuar nga interesi i tij privat apo nuk është provuar që subjekti i rivlerësimit ka kryer favore ndaj shoqërisë ndërtuese, të cilat rrjedhin për shkak të detyrës së tij. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se nuk gjenden elemente që e kualifikojnë këtë rrethanë si një trajtim preferencial, në kuptim të situatës faktike e parashikimeve ligjore në fuqi në kohën e lindjes së marrëdhënies që ka definuar këtë çmim, për pasojë, konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka përfituar trajtim preferencial është i pabazuar në ligj.

20.8. Lidhur me konstatimin e Komisionit se mosdeklarimi i kësaj marrëdhënieje dhe përpjekja për ta justifikuar me shkakun se nuk kishte një dokument të shkruar, mund të konsiderohet si përpjekje e subjektit për të shmangur përgjegjësinë për mosdeklarimin e kësaj marrëdhënieje ndër vite, në kuptim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit pretendon nuk ka pasur detyrimin ligjor për të deklaruar pasurinë që nuk ishte ende në pronësi të tij. Sipas tij, detyrimi për të deklaruar pasuritë e paluajtshme në përdorim apo zotërim të subjekteve është përcaktuar për herë të parë në nenin D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 30 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti ashtu edhe Komisioni referojnë në vendimin nr. 35, datë 15.12.2020, të Kolegjit, që i përket subjektit të rivlerësimit A. K..

20.8/a. Në analizë të këtij shkakui ankimi, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratat periodike vjetore të viteve 2010-2015, por e ka deklaruar vetëm në DIPP-në e vitit 2016 dhe në deklaratën e pasurisë vetting. Ndërsa rezulton se pyetjes që Komisioni i drejtoi subjektit në seancë dëgjimore se përse nuk e kishte deklaruar si adresë banimi adresën e apartamentit të ri që kishte marrë nga shoqëria “{***}” ShPK, ai iu

përgjigj se apartamentet janë në të njëjtën rrugë dhe kanë distancë nga njëri-tjetri jo më shumë se 150-200 m, prandaj nuk e ka vlerësuar se duhej ta deklaronte, por banon njëkohësisht edhe tek banesa e vjetër.

20.8/b. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit e ka përdorur për banim këtë apartament prej 6 vjetësh, duke krijuar një marrëdhënie huapërdorjeje të paformalizuar të apartamentit. Subjekti e ka përdorur për banim këtë apartament si pronar i pritshëm, sepse ka përcaktuar çmimin së bashku me shitësin që në fillim të marrëdhënies dhe, bazuar në raportet e miqësisë, ka pasur sigurinë që nuk do e humbiste të drejtën e përdorimit dhe banimit mbi këtë apartament deri në finalizimin e kontratës së shitjes në vitin 2016. Madje, subjekti ka qartësuar në seancën dëgjimore se që në vitin 2010, jo vetëm ka hyrë për banim në këtë apartament, por ka filluar ta përshtatë dhe arredojë sipas dëshirës së tij, fakt që lë të kuptohet edhe një herë se kishte sigurinë që ky apartament tashmë ishte i tij dhe po sillej në një aspekt si pronar i tij.

20.8/c. Nga sa më lart, referuar parashikimeve të Kodit Civil mbi të drejtat reale, posedimi (sundimi faktik) i sendit të paluajtshëm, deri në kalimin e titullit të pronësisë të premtuar dhe fitimin e tagrave të plota të pronarit të ligjshëm të kësaj pasurie, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin e përcaktuar në nenin 4, germa “a” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, për deklarim të të drejtave reale mbi pasuritë e paluajtshme, por edhe të adresës së banimit të saj, në deklaratat periodike vjetore që nga viti 2010, kur ka filluar të banojë në këtë apartament. Ky deklarim do t’i mundësonte ILDKPKI-së të verifikonte në çdo kohë, jo vetëm pasuritë e subjektit të rivlerësimit, marrëdhënien e tij me personin e lidhur (shoqërinë ndërtuese), por edhe të ushtronte kontroll mbi pasuritë e shoqërisë dhe burimet e krijimit të tyre në kuadër të parashikimeve të ish-nenit 7 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003. Gjithashtu, në vitin 2012, me ligjin nr. 85/2012, është ndryshuar ligji sipërcituar, konkretisht është shtuar germa “f” në nenin 4 të këtij ligji, që përcakton se: *“Subjektet detyrohen të deklarojnë dhuratat dhe trajtimet preferenciale, përfshirë identitetin e personit fizik apo juridik prej nga vijnë këto apo krijohen dhuratat ose trajtimet preferenciale”*. Nga kontrolli i deklaratave të interesave periodike nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar ndonjë marrëdhënie të tillë. Për rrjedhojë, trupi gjykues e vlerësoi të drejtë konstatimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin ligjor të deklaronte në deklaratat e interesave periodike të pasurisë gjatë viteve 2010 – 2016 marrëdhënien me pasurinë apartament me sip. 126 m², të ndodhur në rruga “{***}”, pallati “{***}” ShPK, Tiranë, të cilën e ka përdorur si vendbanim. Trupi gjykues vlerëson se pasaktësia e deklarimeve periodike, në rastin konkret, nuk përbën shkak për deklarim të pamjaftueshëm të pasurisë objekt kontrolli, deklaruar në deklaratën e rivlerësimit, pasi nuk ka rezultuar asnjë e dhënë, sipas së cilës mosdeklarimi i posedimit të kësaj pasurie të ketë shërbyer për fshehjen e veprimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë pasuri, në kundërshtim me detyrimet e tij, sipas legjislacionit në fuqi, për deklarimin e pasurive. Në këtë kuptim, mosdeklarimi i të dhënave të sakta dhe të plota lidhur me vendbanimin, në deklaratat periodike të interesave, jo vetëm nuk e ngarkon me përgjegjësi të drejtpërdrejtë subjektin e rivlerësimit në drejtim të vendosjes së masës disiplinore në ngarkim të tij, por as nuk mund të afektojë procesin e kontrollit të verifikimit të vërtetësisë së deklarimeve në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, lidhur me burimin e krijimit objekt kontrolli, në kushtet kur në zbatim të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, konkretisht parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe

nenit 31 të ligjit nr. 84/2016, për efekt të procesit të rivlerësimit, objekt i kontrollit janë pasuritë, për të cilat subjekti mbarte detyrimin për t'i deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe që janë relevante në këtë proces dhe kontrolli fillon nga verifikimi i deklarimeve të subjektit në të, një qëndrim tashmë i konsoliduar ky në jurisprudencën e Kolegjit²⁹.

20.9. Lidhur me referimin e subjektit të rivlerësimit në vendimin nr. 35 të vitit 2020, të Kolegjit, trupi gjykues konstaton se nuk paraqitet e njëjta situatë. Konkretisht, në rastin e subjektit të rivlerësimit A. K., Kolegji ka konstatuar se *me mosdeklarimin në DIPP-në e vitit 2009 të marrjes në dorëzim të pasurive të paluajtshme nga shoqëria ndërtuese, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur si qëllim të mbajë jashtë vëmendjes dhe kontrollit të organit kompetent (ILDKPKI-së) këto pasuri të paluajtshme dhe veprimet lidhur me to, apo të ketë krijuar të ardhura nga përdorimi/shfrytëzimi/disponimi i tyre, të cilat të mos i ketë deklaruar rregullisht. Përkundrazi, konstatohet se në saje të deklarimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit A. K., ILDKPKI-ja kishte mundësi të ushtronte kontroll mbi pasuritë e shoqërisë dhe burimet e krijimit të tyre, për sa kohë kjo shoqëri ishte deklaruar nga vetë subjekti i rivlerësimit që në DIPPV-në e vitit 2006, si person i lidhur me të, si pasojë e lidhjes së interesit që ishte krijuar me hyrjen në marrëdhënie kontraktuale të shkëmbimit të pronës. Ndërsa, në rastin e subjektit të rivlerësimit Arben Kostandini nuk është deklaruar asnjëherë prej tij në deklaratat e interesave periodike marrëdhënia e tij me shoqërinë “{***}” ShPK. Madje, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar përdorimin e apartamentit dhe as të vendqëndrimit të tij si adresë të dytë banimi në asnjë prej DIPP-ve vjetore, por për herë të parë e ka deklaruar këtë marrëdhënie vetëm në pyetësor, gjatë hetimit administrativ në Komision.*

20.9/a. Një ndryshim tjetër që evidentohet në trajtimin e këtij rasti është se në çështjen (JR) nr. 35/2020, që i përket subjektit të rivlerësimit A. K., atij nuk i janë atribuuar efektet e deklarimit të pamjaftueshëm të pasurive të paluajtshme të fituara nga transaksioni i shkëmbimit të pronës me shoqërinë, për sa kohë nga kontrolli i ligjshmërisë së krijimit të këtyre pasurive, nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të ndodhet në kushtet e parashikuara nga ndonjë prej rasteve të përcaktuara shprehimisht në nenin 33, pika 5, shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016. Ndërsa në çështjen objekt shqyrtimi, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit Arben Kostandini, për këtë pasuri, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, duke u kualifikuar sipas germës “b”, pika 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

20.10. Lidhur me konstatimin e Komisionit se: *“Duket e dyshimtë marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me këtë pasuri (apartament), të cilën ai duket se mund ta ketë blerë që në vitin 2010, por për shkak të mungesës së burimeve financiare e deklaroi blerjen e tij dhe e formalizon me kontratë shitblerjeje në vitin 2016, për efekt të ligjit të vetting-ut në vitin kur u miratua ky ligj”,* subjekti i rivlerësimit pretendon se formalizimi i kontratës së shitjes është bërë në vitin 2016, pasi në këtë moment u siguruan mjetet monetare për blerje dhe jo për të shmangur detyrime deklarimi, si dhe nuk ka pasur qëllim për fshehje, pasi vetë drejtuesja e shoqërisë “{***}” ShPK ka dëshmuar për ekzistencën e marrëveshjes verbale.

20.10/a. Trupi gjykues, nga verifikimi i akteve të fashikullit të Komisionit, konstaton se pagesa nga subjekti i rivlerësimit në llogari të noterit, për qëllim të blerjes së apartamentit me sip. 126 m², është kryer në vitin 2016, referuar mandatit bankar datë 23.09.2016, të Credins Bank, për

²⁹ Vendimet nr. 33/2021 (JR), datë 03.11.2021; nr. 2/2022, datë 15.02.2022 etj.

pagesën e shumës 7.000.000 lekë. Gjithashtu, vërtetimi, datë 11.01.2017, i Bankës Amerikane e Investimeve (ABI), konfirmon se subjekti ka përfituar kredi për dhënien e huasë në shumën 2.500.000 lekë më datë 13.10.2016. Pra, sikurse vërehet, pagesat për likuidimin e çmimit të apartamentit objekt analize janë kryer në vitin 2016, për rrjedhojë dyshimi i Komisionit për pagesa të kryera në vitin 2010 mbetet i pambështetur me dokumentacion provues.

20.10/b. Trupi gjykues çmon të theksojë se faktet e konstatuara gjatë hetimit administrativ si: përdorimi për banim i apartamentit me sipërfaqe të konsiderueshme prej 126 m², për një periudhë të gjatë kohore, të pandërprerë dhe pakundërshtëpërblim (kur palët duke përfituar nga marrëdhënia miqësore e pretenduar mund të ishin dakordësuar edhe për shlyerje me këste të çmimit të apartamentit); si dhe mosmarrja e masave të subjektit për të formalizuar marrëdhënien e pretenduar të përdorimit me një akt të shkruar dhe formalizimin e saj vetëm në prag të deklarimit *vetting*, janë rrethana të cilat u vlerësuan në tërësi me rrethanat e tjera që kanë rezultuar nga hetimi administrative, për të krijuar bindjen e nevojshme për besueshmërinë e subjektit të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

21. *Lidhur me mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për të blerë apartamentin objekt analize*

21.1. Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën (-) 3.438.705 lekë, për të blerë apartamentin me sip. 126 m², nga shoqëria “{***}” ShPK.

21.2. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, kundërshton si të pabazuar dhe kontradiktor konkluzionin e Komisionit mbi pamjaftueshmërinë financiare në shumën (-) 3.438.705 lekë, duke theksuar se vlera reale e këtij bilanci negativ, sipas faqes 22 të vendimit të Komisionit, është (-) 2.738.705 lekë, pasi shuma prej 700.000 lekësh e përfituar nga trashëgimia nga nëna e tij është pranuar si e ligjshme nga vetë Komisioni. Për rrjedhojë, përllogaritja përfundimtare në faqen 24 të vendimit konsiderohet e gabuar dhe në kundërshtim me analizën financiare të vetë Komisionit. Konkretisht, sipas subjektit: (i) Komisioni nuk ka marrë parasysh të ardhurat e ligjshme të bashkëshortes; (ii) shpenzimet e jetesës për vitin 2007 duhet të përllogariten në të njëjtën masë me vitin 2008; (iii) analiza financiare e Komisionit ka probleme që lidhen me përllogaritjet e gjendjeve *cash* në vite.

21.3. Në shqyrtim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, vendimit të Komisionit, si dhe të akteve të depozituara në Komision, Kolegji konstaton dhe vlerëson si vijon.

21.3/a. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit, për këtë pasuri, ka deklaruar: *Apartament me sip.126 m², rruga “{***}”, pallati “{***}”, ShPK, nd. {***}, ap. {***}, Tiranë. Blerë me kontratë shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.09.2016, të noterit J. Zh.. Vlera: 9.500.000 lekë. Pjesa: 100%. Burimi i krijimit: (i) kursime në vite 7.000.000 lekë; (ii) kredi nga Banka Amerikane e Investimeve në shumën 2.500.000 lekë. Marrë kredi për blerjen e apartamentit në Bankën Amerikane të Investimeve me kontratë huaje hipotekore nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.10.2016, me noter J. Zh. në shumën 2.500.000 lekë, me afat*

7 vjet. Kjo pasuri është deklaruar në mënyrë të njëjtë në DIPP-në e vitit 2016. Bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, subjekti ka depozituar disa akte³⁰ që lidhen me këtë pasuri.

21.3/b. Në kuadër të analizimit të burimeve të krijimit të kësaj pasurie, fillimisht, trupi gjykues mori në shqyrtim kursimet ndër vite të deklaruara prej subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, në të cilat bëjnë pjesë edhe të ardhurat e bashkëshortes nga puna në klinika të ndryshme private në vlerën 650.000 lekë, të cilat Komisioni nuk i konsideroi si të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe, për rrjedhojë, nuk i përfshiu në analizën financiare.

21.4. Subjekti i rivlerësimit pretendon se të ardhurat e bashkëshortes, e cila ka punuar si mjeke jashtë orarit në disa klinika private, janë të ligjshme, pasi janë pasqyruar në deklaratat periodike vjetore. Subjekti argumenton se nuk është përgjegjës për mospagimin e tatimeve nga ana e punëdhënësve të bashkëshortes dhe se pasaktësitë në deklaratën e pasurisë *vetting* nuk duhet të kenë ndikim në procesin e rivlerësimit të tij, duke u mbështetur në faktin që bashkëshortja ka ndërruar jetë dhe nuk ka mundur të ruajë dokumentet tatimore, çka e bën atë të jetë në pamundësi objektive për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm. Në mbështetje të argumenteve të tij, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision vërtetimin e datës 03.03.2023, të spitalit “{***}”, i cili konfirmon se për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar nuk ka ruajtur kontratën e shërbimit dhe dokumentacionin e pagesave të kryera, prandaj nuk mund të konfirmojë as shumën e të ardhurave të përfituara dhe as pagesën e tatimit, por vetëm marrëdhënien e punësimit me bashkëshorten e subjektit në vitet 2010 – 2012.

21.5. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues analizoi deklaratimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me këto të ardhura dhe konstaton se:

- i) Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Të ardhura nga puna e bashkëshortes në klinika private për vitet 2011 dhe 2012, në shumën 650.000 lekë.*
- ii) Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, subjekti ka deklaruar: *Paga e bashkëshortes mjeke, klinika mjekësore private “{***}”, Tiranë, shuma 500.000 lekë.*
- iii) Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011: *Të ardhura nga puna jashtë orarit e bashkëshortes, në klinika private në Tiranë, shuma 400.000 lekë.*
- iv) Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012: *Të ardhura nga puna jashtë orarit e bashkëshortes, shuma 250.000 lekë.*

Trupi gjykues konstaton se vlera e të ardhurave të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*, për punën e bashkëshortes së tij në klinika private, nuk përputhet me vlerën e deklaruar prej subjektit në deklaratat e interesave periodike vjetore të dorëzuar pranë ILDKPKI-së.

³⁰ (1) kontratë shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.09.2016, e lidhur midis shitësit shoqëria “{***}” ShPK dhe blerësit Arben Kostandini, për blerjen e apartamentit me sip.126 m², nr. pasurie {***}, vol. {***}, fq. {***}, z. k. {***}, rruga “{***}”, Tiranë, kundrejt çmimit 9.500.000 lekë, i cili do të paguhet nga subjekti në shumën 7.000.000 lekë, në momentin e nënshkrimit të kontratës nëpërmjet llogarisë së noterit dhe shuma 2.500.000 lekë do të paguhet me lëvrimin e kredisë bankare; (2) certifikatë pronësie e apartamentit, datë 01.07.2011, në emër të shoqërisë “{***}” ShPK; (3) mandat bankar datë 23.09.2016, nga Credins Bank, për pagesën e shumës 7.000.000 lekë nga subjekti në llogari të noterit për qëllim të blerjes së apartamentit me sip. 126 m²; (4) vërtetim datë 11.01.2017, nga Banka Amerikane e Investimeve (ABI), që konfirmon se subjekti ka marrëdhënie kredie me këtë bankë; (5) kontratë huaje hipotekore nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.10.2016, e lidhur me huadhënësin ABI Bank dhe huamarrësit Arben e F. Kostandini, për dhënien e huasë në shumën 2.500.000 lekë, si dhe kontratë hipoteke nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.10.2016, e lidhur midis të njëjtave palë për vënien në hipotekë të apartamentit me sip.126 m², pronë e subjektit me qëllim garantimin e kredisë.

21.5/a. Në pyetësonin nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se bashkëshortja e tij, gjatë kohës që punonte si mjeke bakteriologe në Spitalin Obstetrik Gjinekologjik “{****}”, ka punuar jashtë orarit në disa klinika mjekësore private që nga viti 2010 – 2014. Sipas subjektit, një pjesë e pagës nga kjo punë është mbajtur nga vetë institucioni ku ka punuar (klinika e cila duhet të ketë derdhur edhe tatimet) dhe pjesën tjetër e ka përfituar të ardhura nga puna e saj jashtë orarit të punës. Për periudhën 2010 – 2012 janë deklaruar të ardhurat e fituara në vlerën 400.000 lekë dhe të ardhurat e fituara në vitin 2013 në vlerën 250.000 lekë. Subjekti ka shpjeguar se bashkëshortja nuk ka pasur kontratë pune dhe nuk është në dijeni nëse janë paguar tatimet nga këto klinika.

21.6. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se është në pamundësi objektive për të paraqitur dokumentacion lidhur me të ardhurat e bashkëshortes dhe pagimin e detyrimeve tatimore për to dhe, për pasojë, ndodhet në kushtet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues konstaton se nga aktet e dosjes nuk rezulton që subjekti të ketë paraqitur ndonjë kërkesë drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për pagesën e tatimit në burim nga spitali “{****}” apo ndonjë institucion tjetër me të cilin bashkëshortja e tij ka pasur marrëdhënie shërbimi, me qëllim që të vërtetonte përpjekjet e tij për gjetjen e këtij dokumentacioni. Për rrjedhojë, subjekti nuk ndodhet në kushtet e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit, nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër.

21.7. Trupi gjykues, në vijim të analizimit të ligjshmërisë së të ardhurave të bashkëshortes së subjektit, arsyeton se, bazuar në pikën 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon: *[...] Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore [...]*, për qëllim të procesit të rivlerësimit të kriterit të pasurisë, si të ardhura të ligjshme duhen konsideruar vetëm të ardhurat të cilat plotësojnë në mënyrë kumulative këto dy kriteret, që: (i) janë deklaruar; dhe (ii) për të cilat vërtetohet pagimi i detyrimeve tatimore, sipas legjislacionit në fuqi. Subjekti i rivlerësimit nuk provoi se bashkëshortja e tij ka qenë në kushtet e mirëbesimit për pagimin e taksave nga ana e shoqërisë punëdhënëse dhe se nuk ka qenë në dijeni që punëdhënësi i saj po i shmangte detyrimet tatimore. Përkundrazi, nga provat e administruara dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, u krijua bindja se bashkëshortja e tij ka qenë në kushtet e keqbesimit, sa i përket pagesës së detyrimeve që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës. Nuk rezultoi asnjë përpjekje në kohë reale e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, drejtuar punëdhënësit, për pagimin e detyrimeve tatimore dhe pagesën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, prandaj, në këto kushte, subjekti i rivlerësimit nuk mund të mbrohet me pretendimin se ishte punëdhënësi që kishte detyrimin për të kryer këto pagesa.

21.8. Trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë me dokumentacion justifikues pagesën e tatimit për këto të ardhura. Për rrjedhojë, të ardhurat nga puna e bashkëshortes, të cilat janë deklaruar si kursime dhe më pas kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë në vitin 2016, për efekt të procesit të rivlerësimit, nuk plotësojnë kriteret e parashikuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe neni 30 i ligjit nr. 84/2016, për t’u konsideruar si të ardhura të krijuara nga një burim i ligjshëm dhe për të cilat të jenë paguar

detyrimet tatimore, sipas legjislacionit përkatës në fuqi, në kohën e krijimit³¹. Sa më sipër, shkak i ankimit i ngritur nga subjekti i rivlerësimit gjendet i pabazuar.

21.9. Në përfundim, trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit për të mos përfshirë në analizën financiare shumën prej 1.150.000 lekësh, të realizuara nga të ardhurat nga punësimi të bashkëshortes së subjektit, në vitet 2010, 2011 dhe 2012.

21.10. Lidhur me pretendimin e subjektit se shpenzimet e jetesës për vitin 2007 duhet të përlogariten të barabarta me vitin 2008, trupi gjykues konstaton se Komisioni shpenzimet e jetesës për vitin 2007 i ka përlogaritur bazuar në të dhënat e përcjella nga ILDKPKI-ja³² në institucionet e rivlerësimit. Këto vlera janë përdorur nga ILDKPKI-ja, që prej vitit 2004 e në vazhdim, në funksion të kryerjes së detyrave të saj të kontrollit ndaj subjekteve deklaruese. Përcaktimi i këtij zëri shpenzimesh, sipas metodologjisë së ndjekur nga ILDKPKI-ja dhe duke u bazuar në të dhënat e INSTAT-it, për çdo vit të periudhës së analizës financiare, përfshirë vitin 2007, përfaqëson tashmë një praktikë të konsoliduar në jurisprudencën e Kolegjit³³. Në këto kushte, pretendimi i subjektit të rivlerësimit konsiderohet i pabazuar.

21.11. Trupi gjykues mori në shqyrtim edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *Komisioni nuk ka përfshirë në analizën financiare shumën prej 700.000 lekësh, si e ardhur nga pasuria e trashëguar nga nëna e tij dhe, si rrjedhojë, është i gabuar konkluzioni i Komisionit se ai rezulton me mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e apartamentit në vlerën prej (-) 3.438.705 lekësh.*

Trupi gjykues, nga verifikimi i analizës financiare dhe tabelave përkatëse në vendimin e Komisionit, konstaton se ka një lapsus, pasi shuma prej 700.000 lekësh, e deklaruar si e ardhur e përfituar nga trashëgimia e nënës së tij, është pranuar nga vetë Komisioni në vendimin përfundimtar, ndonëse me rezultatet paraprake të hetimit ishte përjashtuar nga analiza financiare, situatë që reflektohet në paragrafin 5.10 të këtij vendimit, në të cilin Komisioni shprehet se: *“Gjithashtu, edhe për vitet 2003 – 2006, analiza financiare e familjes së subjektit, pjesë e së cilës kanë qenë edhe prindërit e tij, rezultoi me balancë pozitive. Duke qenë se prindërit e subjektit të rivlerësimit nuk kanë pasur detyrim për deklarim dhe se në periudhat e sipërcituara (1998 – 2002 dhe 2003 – 2006) analiza ka rezultuar me balanca pozitive, ata kanë pasur mundësi që gjatë kësaj kohe me të ardhura të ligjshme të kursejnë shumën 700,000 lekë të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2012, si shumë e përfituar nga trashëgimia”*. Ndërsa, në pjesën e vendimit të Komisionit lidhur me gjendjen cash, ndër të tjera, citohet se: *“Në përfundim, për sa është arsyetuar më sipër, rezulton se nga analiza e rishikuar financiare, ligjshmëria e kursimeve cash deri më 31.12.2015 është në shumën 4.261.295 lekë (njohur vetëm të ardhurat nga trashëgimia e nënës prej 700,000 lekësh në vitin 2012). Për rrjedhojë, subjekti ka pasur mungesë burimesh të ligjshme prej (-) 2.738.705 lekësh për blerjen e apartamentit, paraqitur në tabelën nr. 9 të vendimit”*. Pra, sikurse konstatohet, shuma e përfituar nga trashëgimia e nënës së tij është përfshirë në analizën financiare.

³¹ Vendimet nr. 7/2019(JR), datë 05.04.2019, paragrafi 23; nr. 8/2019(JR), datë 16.04.2019, paragrafi 63; nr. 19/2019(JR), datë 26.07.2019, konkluzione, faqe 51 dhe nr. 5/2020(JR), datë 13.03.2020, paragrafi 41.9, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

³² Shkresë e përcjellë nga ILDKPKI-ja në Kolegj, datë 04.03.2019.

³³ Vendimet (JR) nr. 18, datë 08.06.2022; (JR) nr. 32, datë 24.07.2023; dhe (JR) nr. 53, datë 15.12.2023, të Kolegjit.

21.12. Lidhur me të ardhurat nga qiraja të përfituara në vitin 2016 në vlerën 144.000 lekë, për të cilin Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë të kësaj vlere, me një diferencë prej 42.000 lekësh më tepër, subjekti i rivlerësimit, në ankim, e pranon se ka kryer një lapsus në vlerën e deklaruar të qirasë, pasi ka përlogaritur tatimin e paguar për qiranë në vlerën 10%, kur në fakt ky tatim është në masën 15%. Subjekti kërkon që kjo pasaktësi të vlerësohet në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit.

21.12/a. Trupit gjykues i rezulton se në deklaratën e pasurisë *vetting*³⁴, subjekti ka deklaruar të ardhura nga kontrata e qirasë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.09.2016, nga data 01.09.2019 – 31.10.2016 (*lapsus në deklaram nga subjekti, duhet 01.09.2016 – 31.12.2016*). Vlëra: 144.000 lekë. Pjesa: 100%. Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar të njëjtën vlerë prej 144.000 lekësh. Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ka konfirmuar³⁵ se subjekti ka deklaruar dhe paguar detyrimin tatimor mbi të ardhurat nga qiraja për periudhën tetor 2016 – janar 2021. Komisioni, referuar pagesave të kryera për tatimin, ka përfshirë në analizën financiare për vitin 2016 të ardhura *neto* nga qiraja në shumën 102.000 lekë [3 muaj x (40.000 lekë/muaj qiraja *bruto* – 6.000 lekë/muaj tatimi mbi qiranë) = 102.000 lekë].

21.12/b. Për sa më lart, trupi gjykues, duke marrë në konsideratë se subjekti i rivlerësimit në ankim e ka pranuar edhe vetë se deklarimi i vlerës së qirasë së përfituar për vitin 2016 është një lapsus dhe pasi konstatoi se diferenca e deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* në vlerën prej 144.000 lekësh, në raport me atë të përfituar në shumën prej 102.000 lekësh është në vlerën minimaliste prej 42.000 lekësh, vlerëson se kjo pasaktësi nuk mund të ngrihet në nivelin për të cilin mund t'i atribuohet si shkelje subjektivitetit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, nuk mund të renditen në grupin e pasaktësive me pasojë shkarkimin nga detyra të subjektivitetit të rivlerësimit në këtë rast, duke i bërë këto të dhëna/fakte jorelevante për t'u kualifikuar dhe konsideruar në nivelin dhe llojin e marrjes së një mase disiplinore për subjektivitetin e rivlerësimit.

22. Trupi gjykues mori në analizë ecurinë e likuiditeteve *cash* ndër vite, me qëllim verifikimin e mundësisë financiare të subjektivitetit të rivlerësimit për të krijuar shumën 7.000.000 lekë, e cila ka shërbyer si burim për krijimin e apartamentit në vitin 2016.

22.1. Komisionit, sipas analizës financiare të viteve 2003 – 2015, i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën (-) 4.649.314,05 lekë, por duke ndjekur praktikën e Kolegjit³⁶, sipas së cilës vetëm kursimet e mundshme *cash* duhet të llogariten si burime të ligjshme për financimin e apartamentit në vitin 2016, rezultoi vlëra 4.261.295 lekë. Ky vlerësim solli rezultat negativ në analizën e vitit 2016, në vlerën (-) 2.428.203 lekë.

22.1/a. Si përfundim, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme në lidhje me krijimin e kursimeve *cash*, të cilat janë deklaruar si burim për blerjen e apartamentit në vitin 2016, burime të cilat nuk përmbushin parashikimet e nenit D, pika 3 e

³⁴ Bashkëlidhur deklaratës *vetting*, subjekti ka depozituar: (1) kontratë qiraje, datë 16.09.2016, e lidhur midis qiradhënësit Arben Kostandini dhe qiramarrësit G. M., për dhënie me qira të apartamentit me sip. 75,50 m², kundrejt vlerës 40.000 lekë/muaj për një afat 2-vjeçar, i cili fillon nga data 01.09.2016; (2) urdhërpagesa të detyrimit tatimor mbi të ardhurat nga qiraja për muajt tetor-dhjetor 2016.

³⁵ Me shkresën nr. {***} prot., datë 25.02.2021, drejtuar Komisionit.

³⁶ Vendimi (JR) nr. 26, datë 06.07.2022, pikat 19.8, 24 dhe 25, i Kolegjit.

Aneksit të Kushtetutës dhe, për rrjedhojë, gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, sipas përcaktimit të nenit 61, pika 3.

22.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se analiza financiare e Komisionit ka probleme që lidhen me përllogaritjet e gjendjeve *cash* në vite, duke listuar elementet si më poshtë:

- i. Komisioni duhet të kishte vlerësuar mundësinë e kursimit të tij dhe të bashkëshortes në funksion të të ardhurave të përfituara gjatë viteve, pa u mbështetur në deklarimet periodike vjetore të pasurisë. Subjekti e justifikon këtë qëndrim me argumentin se, për shkak se ka ngatërruar kuptimin dhe mënyrën e deklarimit të likuiditeteve ndër vite, pasqyrimet në deklaratat periodike nuk përkojnë me gjendjen reale të likuiditeteve në *cash*.
- ii. Sipas pretendimit të subjektit, kursimet e tij nga paga, të cilat janë përfshirë në DIPP-në e vitit 2008, nuk janë përdorur dhe janë mbajtur për t'u përdorur kur të ishte e nevojshme. Ai thekson se gabimet e bëra gjatë plotësimit të deklarave periodike vjetore nuk kanë pasur qëllim fshehjen e të ardhurave.
- iii. Sipas subjektit, përllogaritjet e likuiditetit *cash* të vitit 2014 janë të gabuara. Ai thekson se ka pasur deklarim të pasaktë të likuiditeteve të bashkëshortes, ku është tërhequr shuma 2.600.302 lekë, dhe se tërheqja e likuiditeteve nga banka në shtëpi nuk është marrë parasysh si një shtesë e ligjshme. Kjo ka sjellë një përllogaritje të pasaktë të gjendjes *cash* të vitit 2014, e cila ka ndikuar në vlerësimin e pasurisë.
- iv. Subjekti pretendon se në analizën financiare të Komisionit ka gabime metodologjike, si përllogaritja e diferencave negative në mënyrë të paqëndrueshme. Ai argumenton se duhet të përfshihen vetëm shumat e ligjshme të të ardhurave që janë përdorur për krijimin e pasurive dhe se pas korrigjimeve të bëra analiza financiare për vitin 2016 do të rezultojë pozitive në shumën 341.986 lekë.
- v. Subjekti ka depozituar në ankim dy versione të analizës³⁷ së gjendjes *cash*, ku pretendon se sipas metodologjive që ka ndjekur ka arritur të provojë se ka pasur mjaftueshëm burime të ligjshme për blerjen e pasurisë apartament.
- vi. Subjekti thekson se gjendja *cash* në fund të vitit 2016 është 300.000 lekë dhe se nga analiza financiare qartazi ka mundur të krijojë pasuri të ligjshme gjatë këtij viti, duke refuzuar konkluzionin e Komisionit se ka mungesë burimesh të ligjshme për këtë periudhë.
- vii. Subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit se ai dhe bashkëshortja nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme në shumën (-) 7.077.517 lekë, për të paguar shpenzimet dhe për të krijuar pasuritë, duke pretenduar se kjo balancë negative nuk përputhet me rezultatin final të hetimit, i cili ka evidentuar vetëm (-) 2.738.705 lekë mungesë burimesh.

22.2/a. Në lidhje me mosdeklarimin e gjendjeve të llogarive bankare për çdo vit në deklaratat e interesave periodike të viteve 2005, 2006 dhe 2007, subjekti pretendon se të gjitha shumat e përmendura janë të ardhura nga paga e tij dhe e bashkëshortes, paga të cilat janë deklaruar në deklaratat periodike/vjetore përkatëse të viteve 2005, 2006, 2007, 2008 dhe 2009 në fashën e të ardhurave. Ai shpjegon se nuk ka bërë pasqyrimin e gjendjes së llogarive bankare, duke qenë se këto ishin llogari rrjedhëse me burim të ardhurat nga pagat e tij dhe të bashkëshortes dhe,

³⁷ Dy tabelat e analizës janë të njëjta me ato të depozituara në prapësime në Komision.

sipas tij, të kontrollueshme në çdo kohë. Subjekti, në mbështetje të pretendimeve të tij, ka depozituar dy tabela të përlogaritjeve të mundësisë për kursim.

22.3. Në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të mësipërme të subjektit të rivlerësimit, lidhur me analizën financiare për periudhën 2003-2016, trupi gjykues vlerësoi të merrte në shqyrtim deklaratimet e kursimeve *cash* ndër vite të subjektit të rivlerësimit. Nga analizimi i deklaratave të interesave periodike pasurore, rezultoi se ai ka deklaruar si vijon.

Në DIPP-në e vitit 2007: *Kursime 130.000 lekë. Pjesa: 100%*. Në DIPP-në e vitit 2008: *Kursime 2.300.000 lekë*. Në DIPP në e vitit 2009: *Kursime 4.000.000 lekë*, por në ILDKPKI në datën 01.10.2010 ka sqaruar se janë 400.000 lekë të reja. Në DIPP në e vitit 2010: *Shtuar gjendje cash në banesë për vitin 2010, vlera 1.200.000 lekë. Pjesa: 50%*. Në DIPP në e vitit 2011: *Shtuar gjendje cash në banesë për vitin 2011, vlera 1.000.000 lekë. Pjesa: 50%. Burimi i krijimit: Të ardhura nga pagat*. Në DIPP në e vitit 2012: *Shtuar gjendje cash në banesë për vitin 2011, vlera 1.600.000 lekë. Pjesa: 50%. Burimi i krijimit: Të ardhura nga pagat, nga trashëgimia dhe nga puna jashtë orarit e bashkëshortes*. Në DIPP në e vitit 2013: *Shtuar gjendje cash në banesë për vitin 2013. Vlera: 1.100.000 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhurat nga pagat*. Në DIPP në e vitit 2014: *Kursyer nga pagat 1.029.2656 lekë nga të cilat 359.658 lekë në llogarinë rrjedhëse të pagës sime në Credins Bank dhe 669.608 lekë në llogarinë rrjedhëse të pagës së bashkëshortes në Union Bank*. Në DIPP në e vitit 2015: *Kursyer nga pagat 750.000 lekë gjendje cash në banesë*. Në DIPP në e vitit 2016: *Kursyer 300.000 lekë gjendje cash në banesë*.

22.4. Në procesverbalin e mbajtur me inspektorët e ILDKPKI-së në datën 11.01.2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kursimet prej 2.300.000 lekësh të deklaruara në DIPP-në 2008 përbëjnë shumën e akumuluar në vitet 2005, 2006, 2007 dhe 2008 të pagave të tij dhe të bashkëshortes, të cilat deri në datën 31.12.2007 kanë qenë të kursyera në llogaritë e pagave në Raiffeisen Bank dhe në Intesa Sanpaolo Bank në shumën 1.630.360 lekë. Nga kjo shumë kanë tërhequr gjatë vitit 2008 nga bankat shumën 1.511.000 lekë dhe së bashku me kursimet e atij viti është grumbulluar në total shuma 2.300.000 lekë, e cila nuk është përdorur, por është gjendje në shtëpi për ta përdorur kur të ishte nevoja. Pra, si burim për këto kursime kanë shërbyer të ardhurat familjare nga pagat ndër vite.

22.5. Në pyetësin nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit që të shpjegojë ndryshimet e gjendjes *cash* (shtesa/pakësime), ndër vite dhe të përcaktojë gjendjen *cash* në datën 31 dhjetor të çdo viti. Në përgjigje, subjekti ka pasqyruar për çdo vit 2003 - 2017, kursimet familjare në datën 31 dhjetor (gjendjen e parave *cash* në banesë të akumuluar nga pagat; likuiditetet në banka; si dhe kursimet kumulative). Gjithashtu, në vijim subjekti shpjegon³⁸ se në lidhje me *kursime 2.300.000 lekë*, që ka deklaruar në DIPP-në 2008, pjesë e kësaj shume është edhe shuma 1.200.000 lekë që bashkëshortja e tij ka tërhequr nga Intesa Sanpaolo Bank dhe është mbajtur *cash* në shtëpi për t'u përdorur sipas nevojave të familjes. Shuma 2.300.000 lekë është kursyer, një pjesë në bankë dhe pjesa tjetër *cash* në banesë, e cila përfaqëson kursimet e viteve 2004, 2006, 2007 dhe 2008, siç ka sqaruar subjekti edhe në procesverbalin e ILDKPKI-së të datës 11.01.2011.

³⁸ Përgjigja nr. 12 e pyetësit nr. 2.

22.6. Në vlerësimin e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se duhen pasur në konsideratë dy momente, saktësia në deklarime, si dhe mjaftueshmëria e të ardhurave të subjektit, për të krijuar me burime të ligjshme krijimin e gjendjes *cash*, për rrjedhojë, pasi analizoi deklaratimet e subjekti ndër vite, si dhe ato gjatë hetimit administrativ, konstatoi dhe vlerësoi se:

22.6/a. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime *cash* në deklaratat e interesave periodike të pasurisë (DIPP) për periudhën 2003-2006. Subjekti ka deklaruar për herë të parë kursime në vlerën 130.000 lekë në DIPP-në e vitit 2007, pa specifikuar nëse ishin *cash* apo bankë. Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar kursime në vlerën 2.300.000 lekë, ndërsa gjatë hetimit dhe në deklaratimet në ILDKPKI në vitin 2011 ka qenë kontradiktor për mënyrën e krijimit dhe vendndodhjen e kësaj shume (*cash* apo bankë). Për gjithë periudhën 2003-2016, subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ ka kundërshtuar deklaratimet e tij në DIPP-të vjetore, ka bërë korrigjime të deklaratimeve dhe ka përfshirë në shumatat e deklaruara si *cash* edhe gjendjet në bankë. Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit të Komisionit, ai ka deklaruar se ka pasur kursime në *cash* për çdo vit, duke paraqitur një tabelë me shumatat të cilat janë në kundërshtim me të dhënat e deklaruara në DIPP-të përkatëse. Nga verifikimet e të dhënave bankare, rezultoi se gjendja në llogari bankare nuk përputhej me shumatat e pretenduara.

22.6/b. Trupi gjykues konstaton se, në kuadër të paraqitjes së prapësimeve ndaj analizës së Komisionit, subjekti ka depozituar dy tabela³⁹ të reja analize, që pretendojnë të paraqesin mundësinë e kursimeve *cash*, të cilat jo vetëm që bien ndesh me deklaratimet e mëparshme gjatë hetimit dhe me të dhënat në DIPP, por rezultojnë të jenë të përshtatura në dukje me analizën financiare të kryer nga Komisioni, duke ngritur dyshime të arsyeshme mbi saktësinë dhe besueshmërinë e deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit.

22.6/c. Subjekti i rivlerësimit rezulton, gjithashtu, kontradiktor, pasi në përgjigje të pyetësorit, ka deklaruar gjendje *cash* të përshtatura në varësi të gjendjeve të llogarive bankare, ndërkohë që këto të fundit nuk janë deklaruar prej tij në asnjë rast. Madje, edhe pse në vitin 2011, gjatë procesit të kontrollit nga ILDKPKI-ja, subjektit i është evidentuar si problematikë mosdeklarimi i gjendjeve të llogarive bankare, ai ka vijuar të mos i pasqyrojë ato në deklaratat pasuese (përfshirë vetëm vitin 2014). Konkretisht, në shpjegimet e dhëna në pyetësorin nr. 2, subjekti ka sqaruar se në datën 31.12.2014 kursimet *cash* janë në vlerën 6.698.759 lekë dhe kursime në llogari bankare janë 509.931 lekë, por përsëri ato paraqiten kontradiktore në raport me deklarimin periodik në DIPP-në e vitit 2014, pasi në këtë DIPP subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi ndryshime në gjendjen *cash*, por vetëm ndryshime në llogaritë e tij bankare.

22.6/ç. Trupi gjykues vlerëson se, edhe nëse do të merrej në konsideratë e gjithë shumatat e të

³⁹ Në variantin e parë, duke: (i) përfshirë të ardhurat nga puna e bashkëshortes në klinikat private; (ii) përlllogaritur gjendjet *cash*, sipas përgjigjeve të pyetësorit deri në vitin 2015; (iii) ulur zërin e shpenzimeve të jetesës për vitin 2007, duke pretenduar se në vitin 2016 ka pasur mundësi financiare në shumën prej 6.763.952 lekësh. Në variantin e dytë, duke: (i) përfshirë të ardhurat nga puna e bashkëshortes në klinikat private; (ii) përlllogaritur gjendjet *cash*, sipas të dhënave të DIPP për periudhën 2007-2013 dhe për vitin 2015, ndërsa për vitin 2014 ka ndjekur logjikën e tij, duke pretenduar shtesë në gjendjen *cash* të balancës pozitive; (iii) ulur zërin e shpenzimeve të jetesës për vitin 2007, duke pretenduar se në vitin 2016 ka pasur mundësi financiare në shumën prej 6.693.106 lekësh.

ardhurave nga puna private e bashkëshortes si burim për krijimin e gjendjes *cash*, vlera totale do të afrohej me shumën e deklaruar si shtesë gjendje *cash* në banesë, por në këtë rast hipotetik do të ngrihej një pikëpyetje e rëndësishme dhe logjike mbi mënyrën se si është siguruar mbulimi i nevojave bazë ekonomike të familjes gjatë këtij viti.

22.6/d. Trupi gjykues e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në deklaratimet e kryera në DIPP, për shkak të profesionit të tij, ka ngatërruar mënyrën e deklarimit të likuiditeteve. Ky konkluzion bazohet në faktin se nga kontrolli i mënyrës se si është kryer prej subjektit deklarimi tij në deklaratat e interesave periodike, pasqyrimi i gjendjes së likuiditeteve, rezulton se ai ka përdorur në mënyrë të përsëritur terma të qartë dhe të dallueshëm si: *shtuar gjendja cash, gjendje cash në shtëpi, kursyer nga pagat në llogarinë bankare*, etj., për rrjedhojë, përdorimi i këtyre formulimeve tregon një ndërgjegjësim të plotë të subjektit të rivlerësimit mbi natyrën dhe llojin e pasurisë së deklaruar, si dhe mënyrën e deklarimit.

22.7. Bazuar në këto konkluzione, rezulton se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, në lidhje me ekzistencën e likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar, janë në kundërshtim me deklaratimet e bëra prej tij në deklaratat periodike të interesave private për periudhën 2003–2016. Këto deklarata përbëjnë provën kryesore shkresore në procesin e rivlerësimit, sipas përcaktimeve të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, të cilat, të interpretuara në mënyrë të integruar me deklaratën e pasurisë *vetting*, përbëjnë burimin e vetëm të verifikimit të ekzistencës së pasurisë në formën e likuiditeteve *cash*. Për më tepër, në disa raste janë konstatuar mospërputhje dhe qëndrime kontradiktore të subjektit, në lidhje me faktet dhe rrethanat që lidhen me këto likuiditete. Në këto kushte, pretendimet e subjektit mbeten në nivel deklarativ dhe nuk përmbushin standardin e besueshmërisë së kërkuar për procesin e rivlerësimit.

22.8. Për arsyet e sipërcituara, në përllogaritjet e kryera në Kolegj: **(i)** shumat e deklaruar në DIPPV-të, ndër vite, si *shtuar gjendja cash dhe kursyer nga pagat cash në banesë*, u konsideruan si shtesa të atij viti; **(ii)** shumat *cash* të deklaruar në DIPP-të, ndër vite, u konsideruan si gjendje *cash* në banesë dhe jo si shumatore të likuiditeteve *cash* dhe në bankë, pasi në vitin 2014, subjekti ka deklaruar gjendje të kursimeve në bankë, gjë që kundërshton moskuptimin e nocionit të likuiditetit nga ana e tij; **(iii)** shumat e tjera shtesë të prezantuara gjatë procesit të rivlerësimit dhe në parashtrimet e subjektit në Komision si gjendje likuiditeti, nuk u konsideruan në analizën financiare.

22.9. Në këndvështrim të dispozitave të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, sipas nenit 4 të të cilit subjektet deklaruese kanë detyrimin të deklarojnë çdo shtesë të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, duke e përshkruar atë hollësisht dhe burimin e krijimit të saj dhe situatës faktike konkrete, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit mbi pasaktësitë në mënyrën e deklarimit të likuiditeteve nuk qëndron dhe nuk bazohet në fakte.

22.10. Lidhur me referimin e subjektit për analogji në vendimin nr. 20/2019 të Kolegjit, që i përket subjektit të rivlerësimit G. O., në të cilin, ndër të tjera, citohet se: *Ndodhur në këto rrethana, Kolegji çmon se situata faktike, ndonëse nuk është deklaruar saktë, duhet lexuar e kuptuar në linjën logjike që prapëson subjekti i rivlerësimit, për sa kohë që pavarësisht paqartësisë në deklarim, subjekti i rivlerësimit ka përshkruar ekzistencën e kësaj shume dhe destinacionin e përdorimit të saj*, trupi gjykues konstaton se, pavarësisht se situata në dukje paraqitet e njëjtë, në vendimin të cilit i referohet subjekti, konstatimi i Kolegji lidhet me krijimin dhe përdorimin e shumës si burim për blerjen e apartamentit, brenda të njëjtit vit

kalendarik, në të cilin subjekti i rivlerësimit G. O. ka deklaruar se shtuar gjendjen *cash*, por edhe e ka përdorur atë plotësisht për financimin e pasurisë vlerë. Në rastin e subjektit Arben Kostandini deklaratimet e tij janë në kontradiktë, jo vetëm me të dhënat në deklaratat e interesave periodike vjetore, me deklaratimet e dhëna në ILDKPKI, por edhe me shpjegimet e dhëna nga vetë ai gjatë hetimit administrativ në Komision, duke ngritur dyshime të arsyeshme mbi saktësinë dhe besueshmërinë e deklarimeve të tij, për rrjedhojë krahasimi i situatave të subjektit të rivlerësimit nuk qëndron.

22.11. Lidhur me pretendimin e subjektit se *në analizën financiare për vitin 2008 duhet të përfshihet si mundësi kursimi e gjithë shuma e deklaruar pranë ILDKPKI-së si vlerë e akumuluar e kursimeve ndër vite, përfshirë edhe vitet në të cilat nuk është deklaruar gjendje cash*, trupi gjykues çmon se kjo bie ndesh me parimet e analizës financiare në procesin e rivlerësimit dhe me natyrën deklarative të pasurisë pranë autoritetit kompetent. Për të vlerësuar mundësitë financiare reale të subjektit për akumulimin e kursimeve, nuk mund të përdoret totali i të ardhurave dhe shpenzimeve të grumbulluara ndër vite si bazë për llogaritje, por duhet të merren parasysh vetëm kursimet e deklaruara konkretisht në fund të secilit vit kalendariq, për të cilin subjekti ka pasur detyrimin ligjor për deklarim të saktë pranë ILDKPKI-së. Për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit është i pabazuar.

22.12. Lidhur me pretendimin e subjektit se *Komisioni ka kryer një përlllogaritje të pasaktë të gjendjes cash për vitin 2014, me argumentin se nuk është marrë në konsideratë si shtesë cash-i, shuma e tërhequr nga llogaritë bankare në muajin shkurt të atij viti dhe shumat e tërhequra nga bashkëshortja në shkurt të vitit 2014 janë ruajtur në banesë si kursime për blerjen e një pasurie të paluajtshme në vitin 2016*, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim bie në kundërshtim me të dhënat faktike dhe rrethanat jetësore të periudhës përkatëse. Nga këqyrja e veprimeve bankare, rezultoi se bashkëshortja e subjektit ka tërhequr të gjithë shumën e depozitës dhe gjendjen e akumuluar në llogari më datë 5 shkurt 2014. Nga të dhënat e sistemit rezultoi se bashkëshortja e subjektit ka udhëtuar për në Stamboll në datat 17–20 shkurt 2014 dhe, sipas përgjigjeve në pyetësorin e shpenzimeve të udhëtimit, ka nisur udhëtimet (20 fluturime nga të dhënat e sistemit *TIMS*), për arsye mjekësore në Itali që në muajin mars 2014, e logjikshëm krijohet bindja se kjo shumë e konsiderueshme parash është tërhequr në vitin 2014 nga banka dhe ruajtur në shtëpi për qëllim imediat shëndeti, duke e bërë të pabesueshëm e të pabazuar pretendimin për përdorimin për investim në pasuri të paluajtshme në vitin 2016.

22.13. Lidhur me pretendimin e subjektit se *Komisioni ka kryer disa gabime metodologjike, në përlllogaritjen e gjendjes cash dhe përlllogaritje të diferencave negative në mënyrë të paqëndrueshme*, trupi gjykues konstaton se:

22.13/a. Komisioni, në rezultatet e hetimit dërguar subjektit, ka sqaruar mënyrën e kryerjes së analizës mbi mundësinë e krijimit të shumave në *cash*, ndër vite, duke u mbështetur në parimin ekonomik se: në rastin kur rezultati financiar negativ i një viti (në vlerë absolute) është më i madh sesa shtesa e deklaruar në *cash* për atë vit, atëherë e gjithë kjo shtesë konsiderohet si e krijuar nga burime të pajustificuara ligjërisht dhe subjekti, jo vetëm që nuk ka pasur mundësi të kursejë, por as të ruajë nivelin ekzistues të kursimeve nga viti pararendës. Ndërsa, në rastin kur rezultati negativ është më i vogël sesa shtesa e *cash*-it, vetëm pjesa që mbetet pas zbritjes së rezultatit negativ mund të konsiderohet si e krijuar nga të ardhura të ligjshme.

22.13/b. Trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, pasi kontrollon tabelat përkatëse të analizës financiare mbi mundësinë për kursim të subjektit të rivlerësimit, përfshirë në rezultatet e hetimit dhe në vendim, konstatoi se për vitet 2010 dhe 2013, Komisioni ka zbatuar një qasje metodologjike të ndryshme në krahasim me vitet 2008, 2009, 2011, 2012, 2014 dhe 2015. Ky fakt konstatohet nga tabela nr. 8 e vendimit të Komisionit, ku për vitet 2010 dhe 2013 është përlogaritur një mundësi negative kursimi për subjektin, në kundërshtim me vetë logjikën e shpjeguar prej tij më lart, pasi këto shuma negative janë përfshirë në mënyrë të gabuar në totalin e kursimeve, duke u mbledhur me shumat pozitive të viteve të tjera, për rrjedhojë Komisioni ka shfaqur një mungesë koherence në metodologjinë e përdorur për vlerësimin e mundësisë reale të kursimit për subjektin e rivlerësimit.

22.13/c. Trupi gjykues konstaton, gjithashtu, se edhe në analizën financiare për vitin 2015, Komisioni ka ndjekur një metodologji të ndryshme, duke përfshirë rezultatin e gjeneruar nga analiza e ligjshmërisë për krijimin e *cash*-it, si pjesë të gjendjes *cash* për atë vit, në një interpretim që, sipas Komisionit, përfaqëson shumën *cash* të kursyer në rastin më të mirë. Trupi gjykues vëren se kjo përfshirje e gjendjes *cash*, në vend që të ndihmonte në qartësimin e situatës financiare, ka cenuar logjikën e analizës, duke shkaktuar një dyfishim real të pamundësisë financiare të subjektit dhe jo thjesht në *pamje të jashtme* të saj, siç pretendohet në vendimin e Komisionit. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon të theksojë qëndrimin se analiza financiare duhet të mbështetet mbi të dhëna të deklaruara dhe të provuara, dhe jo mbi përlogaritje të dyfishta që çojnë në penalizim të padrejtë të subjektit për të njëjtin komponent. Në këtë kuptim, ky veprim i Komisionit bie në kundërshtim me parimet e logjikës ekonomiko-financiare, si dhe jurisprudencën⁴⁰ e Kolegjit. Në kushtet kur nga analiza financiare rezultojnë qartë se subjekti nuk ka pasur mundësi reale për krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve të deklaruara dhe kur vetë Komisioni në metodologjinë e ndjekur ka përcaktuar se të dhënat mbi *cash*-in do të mbështeten ekskluzivisht në deklaratimet në DIPP, përfshirja e shumës së analizuar si *cash* në vitin 2015 përbën një devijim metodologjik dhe një mospërputhje me standardin e provës.

22.14. Nga sa më lart konstatuar, lidhur me mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për blerjen e apartamentit në vitin 2016, në përlogaritjet e kryera në Kolegj, në ndryshim me atë të Komisionit, janë konsideruar: (i) të ardhurat nga pagat për subjektin dhe bashkëshorten janë vlerësuar bazuar në vërtetimet përkatëse deri në vitin 2005, si dhe në lëvizjet bankare për periudhën 2006–2016; (ii) të ardhurat nga interesat e llogarive bankare janë rilogaritur, pasi gjatë krahasimit me analizën e Komisionit u evidentuan disa diferenca; (iii) në vitet 2007, 2010, 2013 dhe 2014, duke qenë se balancat negative rezultuan më të mëdha në vlerë absolute se shtesat e shumave *cash*, nuk u konsideruan si *cash* “negativ”, për pasojë si rezultat i korrektimit të këtyre zërave, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën (-) 2.551.800 lekë.

22.15. Në përfundim të analizimit të shkaqeve të ankimit, shqyrtimit të plotë dhe të thelluar të dokumentacionit, deklarimeve dhe analizës financiare të kryer në raport me të dhënat zyrtare të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, trupit gjykues i rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk

⁴⁰ Vendimet (JR) nr. 11/2019; (JR) nr. 19/2019 dhe (JR) nr. 20/2019.

ka arritur të provojë me dokumentacion justifikues ligjor, burimin e ligjshëm të pasurisë së krijuar apo të likuiditeteve të pretenduara *cash* jashtë sistemit bankar.

22.16. Trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit se ka pasur mundësi të kursejë apo të akumulojë shuma të konsiderueshme gjatë viteve nëpërmjet të ardhurave familjare nuk qëndron, pasi nga analiza financiare ai rezulton me një balancë negative të përsëritur ndër vite dhe një pamundësi e qartë për përballimin e shpenzimeve dhe krijimin e pasurive. Subjekti në mënyrë të përsëritur ka kryer deklarime kontradiktore, të paqarta dhe në disa raste të përshtatura sipas rrethanave të hetimit, çka dëmton seriozisht besueshmërinë e deklarimeve të tij. Trupi gjykues e vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në vitin 2016 për mbulimin e shpenzimeve dhe krijimin e pasurive, ndër të cilat edhe krijimin e vlerës prej 300.000 lekësh të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, si gjendje *cash*. Ky konkluzion bazohet në faktin se edhe nga përlllogaritjet e kryera në Kolegj, duke përfshirë një pjesë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, përsëri për vitin 2016 ai ka rezultuar me mungesë burimesh financiare të ligjshme.

22.17. Lidhur me mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për të krijuar shumën prej 7.000.000 lekësh, e cila ka shërbyer si një nga burimet për krijimin e apartamentit në vitin 2016, trupi gjykues, pasi kontrolloi analizën e Komisionit mbi ecurinë e likuiditeteve *cash* ndër vite dhe përfshiu në analizën financiare vlerat e shpjeguara më lart, si dhe korrigjoi llogaritjen e dyfishtë të likuiditeteve në vitin 2015, konstaton se përsëri ato nuk arritën të ndikojnë në ndryshimin e rezultatit përfundimtar të pamundësisë së subjektit të rivlerësimit për justifikimin e pasurisë me burime financiare të ligjshme, e cila është në shumën 2.551.800 lekë.

22.18. Në konkluzion të kontrollit të kësaj pasurie, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të krijuar pasurinë apartament me sip. 126 m², të ndodhur në rrugën “{***}”, pallati “{***}” ShPK, Tiranë, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

23. Në analizën përfundimtare të Kolegjit, për periudhën 2003–2016, mbi burimet financiare të përdorura për krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve bazuar në sa më lart, trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kontrolloi përlllogaritjen e balancave negative të akumuluarra dhe në ndryshim nga vlerësimi i Komisionit që ka konkluduar në vlerën (-) 7.077.517 lekë, arriti në përfundimin se për periudhën në fjalë subjekti rezulton me një pamundësi financiare në shumën (-) 4.728.595 lekë, për të mbuluar shpenzimet dhe për të justifikuar burimet e pasurisë së krijuar.
24. Lidhur me analizën financiare për periudhën 2003 – 2016, trupi gjykues, edhe pse e gjeti të drejtë pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka gabuar në metodologjinë e përlllogaritjes së balancës negative për këtë periudhë, nga kontrolli i analizës së kryer në Kolegj, konkludohet se balanca negative mbetet në një vlerë, e cila nuk mund të çojë në aplikimin e parimit të proporcionalitetit. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve në këto vite, situatë kjo që kualifikohet sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
25. Trupi gjykues, në ndryshim nga Komisioni, vlerësoi se mangësitë e evidentuara lidhur me mënyrën e deklarimit dhe përdorimit të pasurisë apartament me sip. 126 m², të ndodhur në rrugën “{***}”, pallati “{***}”, Tiranë, nuk janë të mjaftueshme për të konkluduar se subjekti

i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te drejtësia, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, por ato u vlerësuan në kuadër të besueshmërisë së tij në vlerësimin e pasurisë.

26. Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme e, për rrjedhojë, është i pabesueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në kuptim të pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke u gjendur, në këtë mënyrë, në një prej rasteve të parashikuara nga ligji për vendosjen e masës disiplinore shkarkim nga detyra. Për sa më lart, vendimi nr. 636, datë 15.03.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 636, datë 15.03.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Arben Kostandini.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm

U shpall, në Tiranë, më datë 22.09.2025.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Mimoza TASI

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi